GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7703 E enjte 8 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER edhe sot me e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga JULIAN ZYLA

Ndahet qeveria në Amerikë, ja mësimet për politikën në Shqipëri

Tashmë Trump nuk do të lëvizë aq lehtë në Uashington. Eskorta e makinave që e shoqërojnë do të vazhdojë të jetë po aq efektive nëpër rrugët e kryeqytetit ...

Vijon në faqen 20

Dje në "Deutsche Welle"

Nga KENO VERSECK

Tregtia korruptive me nënshtetësitë europiane

Nënshtetësia europiane ose leja e qëndrimit, e dhënë për një vend të BE-së janë dokumentet zyrtare më të vështira për t'u marrë në botë, por janë ...

Vijon në faqen 21

EMRAT/ Lista me 1140 "pronarët e rinj"

Legalizimet, familjet në Vorë dhe Tiranë që do përfitojnë lejet

Procedura për tapinë ndiqet nga ALUIZNI. Sipërfaqja totale, jo më e madhe se 500 m²

ALUIZNI publikon listën me 1200 pronarët që kanë gati lejet e legalizimeve në qarkun Tiranë. Sipas ALUIZNI-t të gjithë personat që gjejnë emrin në listat e afishuara duhet të paraqiten pranë drejtorisë për të tërhequr lejen. Bazuar te ndryshimet e fundit ligjore, qytetari duhet të marrë një kopje për të vërtetuar përmbarimin...

Në faqet 10-11

DURRES/ BRESHERI KALLASHI MBI EDISON HARIZAJN, VDES NE SPITAL GENCI CACI

ATENTATI, VRITET "I FORTI I VLORES" DHE SHOKU I TIJ

Si iu bë prita mikut të Shullazit, flasin dëshmitarët. I penduari që e implikoi në zhdukjen e Albano Xhaferrit. Gjendet e djegur makina e autorëve

(Në foto) Edison Haziraj, Genci Caci. Policia në vendin e ngjarjes

Në faqet 2-3

KONCESIONI

Gjiknuri: Tiranë-Durrës bëhet me pagesë, shteti s'ka 200 mln euro

Në faqen 6

ZGJEDHJET NE SHBA

Demokratët marrin shumicën në Kongres, republikanët në Senatin amerikan

Në faqen 17

FLET KREU I SHOQATES

Pacientët me diabet: Nuk kryejmë dot disa prej analizave në spitalin shtetëror

Në faqen 9

INCIDENTI NE BULARAT

Qëlloi mbi policinë shqiptare me armë, Kaçifas varroset sot me flamur grek

Në faqen 8

VIZITA NE ITALI

Meta dhe presidenti Matarella bashkë tek arbëreshët: Urë lidhëse mes 2 vendeve

Në faqen 5

Buxheti/ Parlamenti do prodhojë sinjal televiziv, kosto 4 milionë lekë

Kuvendi, 300 mijë dollarë për blerje makinash

Debatet në komision, propozimi: Paga deri në 40 mijë lekë, pa taksa

Ndonëse një periudhë e shtrëngimit financiar, blerja e automjeteve mbetet një nga kërkesat më të shpeshta nga institucionet shtetërore, thuajse në çdo buxhet që paraqitet për miratim. Përjashtim nga kjo nuk bën as Kuvendi i Shqipërisë, i cili në buxhetin e tij për vitin 2018 kishte parashikuar një zë të veçantë "blerje autoveture" në vlerën e 355 milionë lekëve. Është vetë Shërbimi i Financës dhe Buxhetit në Kuvendin e Shqipërisë, ai që në relacionin mbi zbatimin e buxhetit të këtij institucioni për 4-mujorin e parë ...

Në faqet 6-7

ATENTATI MAFIOZ

HETIMET

Shoqërohen 20 persona, policia: Ngjarja, për hakmarrje ose larje hesapesh mes bandash

Si u ekzekutuan në pritë i "forti" i Vlorës, Edison Harizaj dhe shoku i tij, Genci Caci

Miku i Shullazit dhe 33-vjeçari u qëlluan me breshëri kallashnikovi nga dy automjete



Vendi ku ndodhi vrasja e dyfishtë

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një atentat mafioz ka tronditur Durrësin mbrëmjen e së martës. Edison Harizaj nga Vlora, i cili njihej si krahu i djathtë i Emiliano Shullazit si dhe shoku i tij, Genci Caci janë ekzekutuar me breshëri kallashnikovi. Burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se dy vlonjatët u qëlluan në pritë nga persona ende të paidentifikuar, teksa po udhëtonin me automjetin tip "Audi A8" me targa AA857. Për pasojë, ka mbetur i vdekur në vend 39-vjeçari Harizaj, ndërsa 33-vjeçari Caci mbeti i plagosur rëndë. Ky i fundit u dërgua fillimisht në spitalin e Durrësit dhe më pas në Spitalin e Traumës në Tiranë, ku dhe ndërroi jetë mbrëmë nga plagët e shumta që kishte marrë në trup. Sipas burimeve të mësipërme, ngjarja e rëndë u shënua rreth orës 22:50 në lagjen nr.13 të qytetit të Durrësit, në rrugën "Lagja e Çamëve". Menjëherë pas sinjalizimit për atentatin, forca të shumta policie kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, blutë kanë gjetur në varrezat e Shën Vlashit (afro 4 km larg vendit të ngjarjes) një makinë "Benz" të braktisur dhe të djegur, e cila dyshohet se është përdorur nga atentatorët. Nisur nga rrethanat e krimit, dyshohet se vrasja e dyfishtë ka ndodhur për larje hesapesh mes bandave rivale, ndërsa po hetohet dhe pista e hakmarrjes. Ndërkaq, burimet e mësipërme bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se në lidhje me atentatin në fjalë janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 20 persona në Durrës, Tiranë dhe Vlorë, por ende policia nuk ka rënë në gjurmët e autorëve të krimit.

39-vjeçari i vrarë Edison Harizaj

33-vjeçari i vrarë Genti Caci

20

TË SHOQËRUAR

Burime nga policia dje bënë me dije se në lidhje me atentatin mafioz ku mbetën të vrarë Edison Harizaj dhe shoku i tij 33-vjeçar, Genci Caci janë shoqëruar dhe marrë në pyetje mbi 20 persona në Durrës, Tiranë dhe Vlorë. Pavarësisht hetimeve intensive nga policia, ende nuk është bërë i mundur identifikimi dhe arrestimi i atentatorëve.

Denoncimi

ISH-KRYEMINISTRI

Ish-kryeministri Berisha denoncoi dje se viktima e atentatit në Durrës, Edison Harizaj, njihet si bos i drogës në Vlorës. Referuar qytetarit dixhital, Berisha shprehet se viktima ishte mik me Olsi Ramën dhe Geron Xhafajn. "Ai ka pasur lidhje direkt me Edi Ramën dhe Fatzi Xhafajn. Në këtë atentat u plagos rëndë dhe një bashkëpuntor i tij", shprehet z.Berisha.

VIKTIMA KUPTOI SE PO E NDIQNIN

Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet që i "forti" i Vlorës, Edison Harizaj, i cili po drejtonte "Audi"-n luksoz në pronësi të shokut të tij, Genci Caci (ky i fundit ishte pasagjer dhe i paskeduar nga policia) mund të ketë pikasur se po ndiqej nga pas nga një automjet i dyshimtë. Kjo, nisur nga fakti se viktima ka qenë duke lëvizur me shpejtësi të madhe. "Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, është vënë re frenimi i fortë i makinës, me të cilën po udhëtonte viktima. Ai ka qenë duke lëvizur me shpejtësi 200 km në orë, kur i ka prerë rrugën një mjet tjetër. Në çastin kur ka ndaluar Edison Harizaj, makina tip "Audi" është qëlluar me dy kallashnikovë nga të dyja krahët", thanë burimet policore.

ATENTATI

Edison Harizaj, një emër i njohur për policinë si i dyshuar për një sërë ngjarjesh të rënda të ndodhura në qytetin e Vlorës, ishte duke udhëtuar nga kryeqyteti në drejtim të Vlorës. 39-vjeçari, i cili ishte shoferi i automjetit "Audi A8", sapo ka lënë autostradën Tiranë-Durrës është futur në Unazën e plazhit dhe pastaj ka hyrë në "Rrugën e Çamëve". Kishte bërë vetëm 20 metra në këtë rrugë, kur ai dhe miku i tij 33-vjeçar, Genci Caci kanë rënë në pritën e atentatorëve, të cilët i kanë qëlluar me breshëri kallashnikovi. Kanë qenë banorët e zonës që kanë njoftuar forcat e policisë për ngjarjen. "Më datë 06.11.2018, rreth orës 22:50, në lagjen nr.13, Durrës brenda një mjeti tip 'Audi' është gjetur pa shenja jete shtetasi E.H. 39 vjeç, banues në Vlorë dhe i plagosur shtetasi G.C. 33 vjeç, banues në Vlorë, i cili ndodhet në Spitalin Rajonal Durrës nën kujdesin e mjekëve. Grupi hetimor vijon punën për identifikimin dhe kapjen e autorëve si dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar paraprak të policisë së Durrësit.

SKEMA E VRASJES SË DYFISHTË

Pas mbërritjes në vendin e ngjarjes, blutë kanë bërë rindërtimin e skemës së vrasjes. Sipas hetuesve të çështjes, në atentat janë përdorur dy makina. Dyshohet që i "forti" i Vlorës, Edison Harizaj, i cili po drejtonte "Audi"-n luksoz në pronësi të shokut të tij, Genci Caci (ky i fundit ishte pasagjer dhe i paskeduar nga policia) mund të ketë pikasur se po ndiqej nga pas nga një automjet i dyshimtë. Kjo nisur nga fakti se viktima ka qenë duke lëvizur me shpejtësi të madhe. Mesa duket, Harizaj ka tentuar të largohet, ndaj është futur në "Rrugën e Çamëve", por pa e ditur se përpara do i zinte pritë një automjet tjetër. Në momentin që është gjendur përballë këtij mjeti, ai ka ndaluar për të shmangur përplasjen. "Nga këqyerja e vendit të ngjarjes, është vënë re frenimi i fortë i makinës me të cilën po udhëtonte viktima. Ai ka qenë duke lëvizur me shpejtësi 200 km në orë. Në çastin kur ka ndaluar, Edison Harizaj ka rënë në pritë. Makina tip "Audi" dyshohet të jetë qëlluar nga dy persona me dy kallashnikovë, nga të dy krahët. 39-vjeçari dhe shoku i tij, Genci Caci janë bërë shoshë nga plumbat. Po të njëjtat burime u shprehën se vendi ku autorët ekzekutuan mikun e Shullazit nuk ka ndriçim. Pas krimit, atentatorët janë larguar në sens të kundërt të autostradës, në rrugën dytësore që të çon në zonën e Shën Vlashit të Durrësit, ku dhe kanë djegur makinën tip "Benz", me të cilën kryen vrasjen, e cila ishte e vjedhur. Më pas janë larguar me shpejtësi me një tjetër automjet për të humbur gjurmët. Atentati i kryer mbrëmjen e së martës ka alarmuar policinë, e cila po heton intensivisht për kapjen e atentatorëve. Mësohet se blutë kanë sekuestruar pamjet filmike të kamerave të sigurisë së disa hoteleve për të parë lëvizjet e autorëve të krimit.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës
së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Si u lirua nga Burgu i Fushë-Krujës "Edison Faqedjeguri"

Vrasja e dyfishtë te "Rruga e Çamëve", banorët: U tmerruam, fikëm dritat nga breshëria e plumbave

DURRËS - Atentati i ndodhur në lagjen nr.13 të Durrësit ka shkaktuar panik tek banorët e zonës. Dëshmitarët kanë treguar tmerrin që kanë përjetuar në shtëpinë e tyre, si pasojë e breshërisë së plumbave, ku mbetën të vrarë miku i Emiljano Shullazit, 39-vjeçari Edison Harizaj si dhe shoku i tij Genci Caci, 33 vjeç. Një dëshmitare që ka shtëpinë afër vendit të ngjarjes, te "Rruga e Çamëve", tregoi dje për "Gazeta Shqiptare" momentet e tmerrit që ka përjetuar bashkë me djalin e saj. Ajo pohoi se kur kanë dëgjuar breshërinë e kallashnikovit kanë fikur dritën nga frika. "Ishte ora rreth 11:00. Ne ishim ulur në divan në shtëpi me djalin dhe po bisedonim. Dëgjuam breshëri kallashnikovi. Fikëm dritën për momentin. I thashë djalit çfarë bëhet kështu. Djali më tha se ka filani kallash e mos qëllon ai. Pasi fikëm dritat, djali hipi lart dhe

Vendi ku ndodhi ngjarja

më tha se e paskan vrarë një person, pasi dukej. Nuk dolëm fare, se kishim frikë se na vinin plumbat në oborr. Pas 5 minutash erdhi policia. Djali hipi në tarracë dhe po shikonte. Makina e autorëve mori kthesën dhe iku me shpejtësi", - u shprehë gruaja. Ndërsa, një banor tjetër tha se dëgjoi zhurmë të fortë dhe se u frikësua. "Ishte zhurmë shumë trishtuese, sepse nuk dëgjohen zhurma të atilla. Mendova se mund të shpërthejnë mina, absolutisht që nuk e mendova ashtu. Vetëm që fëmija dhe gruaja u trembën shumë", pohoi banori. Viktima Edison Harizaj, i njohur ndryshe dhe si "Edison Faqedjeguri", pronar i kompleksit "Oslo" në Vlorë ishte person me precedentë penalë dhe ka qenë i dënuar për vrasje. 39-vjeçari Edison Harizaj ka qenë i skeduar si i përfshirë në disa ngjarje kriminale në vend. Ai ka qenë i dënuar me 10 vite burg për vrasje. Dënim që e kishte përfunduar në vitin 2010. Nga burgu i Fushë-Krujës në atë kohë doli duke paguar lekë. Harizaj u arrestua më 7 mars 2000, pasi akuzohej dhe më pas u provua se në bashkëpunim me Skedrijald Pashajn kishin vrarë me armë zjarri më 22 korrik 1999, Erion Ahmetin si dhe kishin plagosur rëndë shtetasit F. D dhe N. R..

LIRIMI NGA BURGU

Edison Harizaj ka qenë i skeduar si i përfshirë në disa ngjarje kriminale në vend. Ai ka qenë i dënuar me 10 vite burg për vrasje. Dënim që e kishte përfunduar në vitin 2010. Nga burgu i Fushë-Krujës në atë kohë doli duke paguar lekë. Harizaj u arrestua më 7 mars 2000, pasi akuzohej dhe më pas u provua se në bashkëpunim me Skedrijald Pashajn kishin vrarë me armë zjarri me 22 korrik të vitit 1999, Erion Ahmetin si dhe kishin plagosur rëndë shtetasit F.D dhe N.R..

Nga ekzekutimi e gjyqtarit Skerdilajd Konomi, gjobat, droga e tritoli, ja kush ishte "Il Padrino" i Vlorës

"Edison Harizaj porositi vrasjen e Albano Xhaferrit"

Dëshmitari i penduar, Gazmend Merkaj: E goditën me çekiç, i zhdukën trupin

VLORË

Edison Harizaj, ose "Il Padrino" apo "Edison Faqedjeguri" dhe "Edisoni i shtatë pallateve", siç njihet ndryshe në qytetin bregdetar të Vlorës dyshohet se është ekzekutuar për hakmarrje (pista kryesore e hetimit), pasi ka qenë i përfshirë në zhdukjen e Albano Xhaferrit dhe Elvis Troqes në Vlorë. Ai ka qenë i dënuar me 10 vite burg për vrasje dhe plagosje të kryer në vitin 1999 në Vlorë, dënim, të cilin e kishte përfunduar në vitin 2010. Gjithashtu, 39-vjeçari, pronar i kompleksit luksoz "Oslo" në lagjen "Uji i Ftohtë", në Vlorë është hetuar dhe për ekzekutimin gjyqtarit Skerdilajd Konomi, por nuk u gjetën prova. Ndërkaq, Harizaj dyshohej se u vinte gjoba biznesmenëve në Vlorë si dhe merrej me trafik droge e vendosje eksplozivi.

KRIMET NË VLORË

Gazmend Merkaj, i cili është vetëdorëzuar më 1 gusht të këtij viti në policinë e Fierit, vetëm pak orë pasi kishte raportuar në policinë e Vlorës se në automjetin e tij tip "BMW" ishte vendosur një sasi eksplozivi, ka shfaqur gatishmërinë për të treguar një krim të rëndë. Bëhet fjalë për vrasjen dhe zhdukje e të riut Albano Xhaferrit në Vlorë. Dëshmitari i penduar ka treguar se e ka ndjerë veten të kërcënuar për t'u vrarë nga anëtarët e një grupi kriminal në Vlorë dhe më konkretisht nga Ardit Kola, Aleksandër Çaushaj dhe Ilir Shakaj. Sipas Merkajt, pikërisht këta persona kanë vrarë me çekiç në makinë Albano Xhaferrin dhe më pas trupin e tij e kanë zhdukur. Gjithmonë sipas tij, një veprim i tillë është kryer për llogari të shtetasit Edison Harizaj, një tjetër emër i njohur në Vlorë. Sipas të dhënave që ka mbledhur Prokuroria e Vlorës, ka arritur në konkluzionin se bazuar në veprimet e para hetimore, rezulton se Albano Xhaferri është vrarë për shkak të mosmarrëveshjeve që mund të ketë pasur brenda ose jashtë shtetit me persona të tjerë dhe trupi është transportuar dhe fshehur për të bërë të pamundur zbardhjen e ngjarjes.

I zhdukuri Albano Xhaferri

Gjyqtari Skerdilajd Konomi

NOFKAT E HARIZAJT

Në Vlorë, Edison Haziraj njihej me emrin "Il Padrino", "Edisoni i shtatë pallateve" apo "Edison Faqedjeguri", pasi në moshë të vogël kishte pësuar një djegie në faqe dhe asgjë nuk bëhej pa miratimin e tij. Njihej me nofkën "Edisoni i shtatë pallateve" pasi rrinte tek zona e njohur si "Shtatë pallatet" në Vlorë, aty ku kishte dhe biznesin e tij.

FRIKA E HAKMARRJES

Sipas burimeve policore, pas dëshmisë së dëshmitarit të penduar Gazmend Merkaj, ku implikonte Edison Harizajn në rrëmbimin dhe vrasjen e Albano Xhaferrit, 39-vjeçari që u ekzekutua mbrëmjen e së martës ishte zhvendosur nga Vlora në Durrës ku fshihej. Mësohet se Harizaj i trembej ndonjë hakmarrjeje të mundshme në Vlorë, ndaj dhe fshihej në Durrës ku dhe u vra në një atentat mafioz.

URDHRI PËR VRASJEN E ALBANO XHAFERRIT

Për zhdukjen e Albano Xhaferrit i është marrë deklarim Gazmend Merkajt, banues në Vlorë, i cili është në lidhje shoqërore me shtetasit Ardit Kola dhe në datën 1 gusht 2018 është vetëdorëzuar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, duke shpjeguar se ndihej i kërcënuar për jetën nga shtetasit Ardit Kola, Aleksandër Çaushaj dhe Ilir Shakaj. Ai ka shpjeguar se ka dijeni për zhdukjen e shtetasit Albano Xhaferri, pasi ka qenë me shtetasit e mësipërm kur ata kanë organizuar dhe marrë atë, me qëllim për ta dorëzuar në ambientet e kompleksit "Oslo", në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, për llogari të shtetasit Edison Harizaj. Merkaj ka shpjeguar gjithashtu se ka mësuar nga shtetasit Ardit Kola, Aleksandër Çaushaj dhe Ilir Shakaj se shtetasi Albano Xhaferri është vrarë me mjete të forta që në momentin që është marrë në automjetin e markës "Audi" me targë AA 560 TR dhe më pas është dërguar për në garazhet në posedim të shtetasit Edison Harizaj në kompleksin "Oslo". Ai ka shpjeguar se është kryer me urdhër të Edison Harizaj, për shkak se Albano Xhaferri ka pasur dijeni për autorët e tentativës së vrasjes së Ferdinant Llanaj në muajin tetor të vitit 2017. Për sa u përket automjeteve të përdorura për marrjen dhe më pas për vrasjen e shtetasit Albano Xhaferri, i penduari Gazmend Merkaj ka shpjeguar se fillimisht ishte programuar dhe organizuar që Albano Xhaferri do të ruhej për lëvizjet e tij me një automjet të markës "Mercedes Benz 250", me ngjyrë kafe të errët, në përdorim të shtetasit Aleksandër Çaushaj, të cilit i kishin bërë edhe dy vrima në bagazhin e tij për të vrojtuar lëvizjet e Albano Xhaferrit.

INSTITUCIONET
KËRKESAT

Kryeprokurorja Marku kërkon 197 punonjës shtesë, PS: Absurde! Shifër e frikshme

Presidenca "refuzon" buxhetin shtesë, Fino: 85 punonjës janë shumë

"KQZ kërkon ambiente të reja dhe dy makina"

Valentina Madani

Përplasja e ditëve të fundit mes Presidentit Ilir Meta dhe kryeministrit Edi Rama nuk u reflektua dje në komisionet parlamentare teksa u diskutua projektbuxheti për vitin e ardhshëm. Institucioni i Presidentit të Republikës nuk pati asnjë kërkesë në Komisionin e Ligjeve për buxhetin në 2019. Përfaqësuesit e kreut të shtetit u shprehën të kënaqur me fondin e përcaktuar për Presidencën në buxhetin e vitit 2019. Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, Alqi Balko deklaroi se nevojat janë të pafundme, por buxhetin e cilësoi realist duke qëndruar në shifrat e një viti më parë. "Nuk kemi asnjë kërkesë shtesë krahasuar me vitin aktual. Nevojat janë të pafundme, por buxheti është realist", Alqi Balko, sekretar i Përgjithshëm i Presidentit. Por deputeti i PS, Bashkim Fino u shpreh se presidenti ka një staf me një numër më të lartë punonjësish sesa duhet. Ai tha se 85 punonjës për një president janë shumë, ndërsa kritikoi edhe zërin e investimeve. "Nuk pengohet veprimtaria e Presidentit të Republikës, madje ka më shumë se ç'duhet po ta shohim nga pikëpamja financiare. Ka më shumë se sa duhet. 85 veta për një president. Janë goxha fond. Kanë realizuar shumë pak fondet e investimeve. Nëse nuk i bëni, jua japim të tjerëve", theksoi z.Bashkim Fino. Ndërsa sekretari i Presidencës u përgjigj për kritikat për investimet duke thënë se 'procedurat janë kryer. I mbyllim brenda vitit'.

PROKURORIA

Prokuroria e Përgjithshme kërkon 197 punonjës shtesë për vitin 2019. Në Komisionin e Ligjeve u zhvillua dje seanca dëgjimore me përfaqësuesin e prokurorisë së përgjithshme Abazi për buxhetin. Deputeti i PS, Bashkim Fino u shpreh kundër kërkesës së prokurorisë duke e cilësuar këtë shifër të frikshme. "Kjo i bie si të ngresh nga e para institucionin e prokurorisë. Shifër e frikshme. Ministria e Financave ka shtuar 50. Por ne nuk dimë ne çfarë nivelesh do shkojnë stafet e rinj. Ku janë? Mua më duket absurde. Unë personalisht nuk do ta pranoja. Ka pasur 130 milionë lekë për investim, por ka shpenzuar vetëm 52. Jua heqim fare. Ja japim një njeriu që di të investojë më mirë", tha Fino. Por, përfaqësuesi i prokurorisë sqaroi pozicionet ku planifikohet të vendosen punonjësit e rinj. "Shtesa për 197 punonjës është mbi ligjin e ri të prokurorisë së përgjithshme: 30 i duam oficerë të policisë gjyqësore, 100 sekretarë pranë çdo prokurori, 5 specialistë për dekriminalizimin, 30 ekspertë të fushave të ndryshme sipas ligjit të ri. Investimet do t'i kryejmë deri në fund të vitit. Nuk djegim asnjë qindarkë", arsyetoi përfaqësuesi i prokurorisë.

"DREJTËSIA"

Institucionet e reja të drejtësisë, si Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si dhe Komisionerët Publikë, kërkuan dje shtesë në fonde pasi shuma e dhënë nuk përballon shpenzimet në pagat e punonjësve: KPA- 56 milionë lekë, KPK - 20 milionë lekë. Komisioneri Publik- 14 milionë lekë, Gjykata Kushtetuese -10 milionë lekë. Kërkesa e Shkollës së Magjistraturës për një automjet ngjalli debate mes deputetëve. Sokol Sadushi tha: "Automjeti lidhet vetëm me nevojat e shkollës dhe nuk lidhet me nevojat e drejtorit. Kurse Bashkim Fino u shpreh: "Mendoja se drejtori s'duhet të vinte fare. Të dërgonte një letër falënderimi dhe të mos vinte të na hante kohën". Deputeti Alket Hyseni kërkoi: "Bashkim ju jeni gjirokastrit. Nuk është serioze që të diskutojmë një 5 milionë lekësh, le ta vërë zoti Fino dorën në zemër, edhe Erjon Braçen do ta bindim dhe ta kalojmë atë". Ministria e Brendshme kërkesën për fonde e bëri në Komisionin e Sigurisë. Julian Hodaj tha: "Zërat e buxhetit janë shpenzime personeli, shpenzime për investime". Ndërkaq në Komisionin e Ligjeve, deputetët deklaruan se Ministrisë së Brendshme duhet t'i shkurtohen fondet, kjo pasi sipas Bashkim Finos nuk ka realizuar investimet e vitit të shkuar.

KOMISIONI

2019 është vit zgjedhor dhe buxheti ka planifikuar një fond të veçantë, 600 milionë lekë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Por, kryetari i institucionit të zgjedhjeve në Shqipëri, Klement Zguri kishte disa kërkesa specifike në Komisionin e Ligjeve, mbi të gjitha zhvendosjen në institucione të reja. "Parimisht jemi dakord për fondet e miratuara për KQZ. Fondet krahasuar me vitin 2018 janë thuajse në të njëjtin nivel. Meqë do jetë vit zgjedhor, 600 milionë lekë është fondi i veçantë. Kërkojmë fond për rikonstruksionin e magazinës së bazës materiale në Lundër. Kërkojmë zhvendosjen në ambiente të reja. Kemi kërkesa edhe për dy automjete të reja. Kërkojmë 47 milionë lekë më shumë",-tha z.Zguri. Por Bashkim Fino, që është relatori i buxhetit iu përgjigj duke e kundërshtuar "keni ambiente të reja dhe shumë më të mira se ne".

Komisioni i Ligjeve

KËRKESA

Shkolla e Magjistraturës nuk mundi të bindë "Ligjet" që ta lejojë të blejë një makinë, edhe pas përpjekjeve të deputetit të PS, Alket Hyseni. Ai iu drejtua socialistit Fono: "Bashkim ju jeni gjirokastrit. Nuk është serioze që të diskutojmë një 5 milionë lekësh, le ta vërë zoti Fino dorën në zemër, edhe Erjon Braçen do ta bindim dhe ta kalojmë atë".

Presidenti Ilir Meta, dje në Kalabri

PD: "Dosja 339", radiografia e pushtetit të lidhur me krimin

Për Partinë Demokratike 'dosja 339' është radiografia e pushtetit të lidhur me krimin, në shërbim të krimit. Deputeti demokrat Gent Strazimiri deklaroi se zbardhja deri në fund e krimit elektoral në 'dosjen 339' është e panegocueshme. Sipas tij dosja "339" nuk duhet të lihet në harresë pasi ajo është radiografia e pushtetit të lidhur me krimin. Për selinë blu arrestimi i Dakos është hapi i parë i domosdoshëm në luftën kundër krimit dhe se çdo ditë liri për kryebashkiakun e Durrësit nënkupton paprekshmëri të bandave. "Në përgjimet e dosjes 339 është faktuar simbioza e pushtetit me krimin, përmes komunikimit sistematik me bandat të Vangjush Dakos, udhëheqësit politik të fushatës në Durrës, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve, respektivisht për të siguruar përkrahjen e ndërsjelltë, përmes favoreve të ndërsjellta duke shprehur në fund edhe mirënjohjen e ndërsjelltë për "zgjidhjen e halleve" të ndërsjellta. "Harresë" për dosjen 339 nuk do të ketë dhe arrestimi i Vangjush Dakos është prova nëse në Shqipëri do të ketë apo jo drejtësi, do të ketë apo jo luftë kundër krimit, do të ketë apo jo normalitet ligjor e elektoral dhe për pasojë qeveri legjitime, si në çdo shtet normal", tha z.Strazimiri.

Përplasja me Metën, Vasili: Rama e di Kushtetutën koncesion

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili reagoi dje në lidhje me kohën që Rama i dha Presidentit Meta për reflektimin në lidhje me dekretimin e Sandër Lleshit. Vasili shtron shumë pyetje në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, votat për Arta Markun dhe votimet e 2017-ës. "Kryeministri, që e di Kushtetutën PPP (koncesion). Po ku e gjeti këtë kohë kushtetuese ky derdimen që e jep dhe e merr?! Apo e konsideron Kushtetutën PPP (koncesionin) e radhës që e gris, e shqyen dhe e bën si të dojë vetë. Apo do bëje po vetë edhe Gjykatën Kushtetuese? Po kur zgjodhi me 69 vota Arta Markun e harroi Kushtetutën? Po pse e harroi ky Kushtetutën, kur i bëri thirrje policisë të hidhte uniformën e të bënte vota për të, apo kur bënte prokurorin paralel për audiopërgjimin e Agron Xhafajt? Ky po flet gjoja edhe në emër të votave që gjoja paska fituar. Po cilave vota? Atyre që Këshilli i Evropës deklaroi se mbi 20% ishin blerë. Apo të atyre votave që i ka grabitur me kriminelë, që kanë dalë sheshit nga përgjimet e prokurorisë",-deklaroi z.Vasili.

Lleshi, krah ministrave në faqen zyrtare të qeverisë

Pas votimit në seancën e jashtëzakonshme të së martës në Kuvend për shkarkimin nga detyra të Fatmir Xhafajt nga post i ministrit të Brendshëm, në faqen online të kryeministrisë janë bërë edhe përditësimet e fundit në përbërjen e kabinetit qeveritar. Edhe pse e emëroi në postin e zv/ministrit të bren-dshëm, për shkak të mos dekretimit nga kreu i shtetit, Sadër Lleshit është të renditur krah ministrave të kabinetit qeveritar, kjo pasi sikundër u shpreh edhe kryeministri, Lleshi do të mbajë postin e zv/ministrit, por do të jetë në krye të punëve të brendshme.

Përplasja në Tiranë, Meta e Majko këndojnë së bashku në Kalabri: Si të lashë e më s'të pashë...

Mattarela e Meta mes arbëreshëve, dy presidentët në Kalabri

"Arbëreshët mbajtën gjallë identitetin kombëtar"

Valentina Madani

Sergio Mattarella dhe Ilir Meta dy presidentët ai i Italisë dhe Shqipërisë u shfaqën dje bashkë mes komunitetit arbëresh në Kalabri. Së bashku ata morën pjesë në ceremoninë përkujtimore të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbe, e cila u zhvillua në kolegjin e njohur arbëresh Shën Adriano ku kanë studiuar figurat më të larta të letërsisë e patriotizmit shqiptaro-arbëreshë. Presidenti Meta gjatë takimit me Sergio Mattarellën, pas ceremonisë solemne, zhvilluan një takim kokë më kokë, ku biseduan për lidhjet e vjetra historike dhe të miqësisë, mbi partneritetin strategjik si dhe thellimin e bashkëpunimit të gjithanshëm mes dy vendeve dhe popujve tanë, dhe më pas iu drejtuan të pranishmëve në sallën e teatrit të Kolegjit. Në fjalën e tij, Presidenti Meta, theksoi se Shën Mitër Korona dhe Kolegji i "Shën Adrianit" është djepi i arsimit dhe kulturës arbëreshe, ku ka dhënë mësim De Rada, dhe njëri prej studentëve ka qenë Luigj Gurakuqi, figura frymëzuese dhe kontribuuese të Rilindjes sonë Kombëtare dhe shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. "Edhe pse larg mëmëdheut të tyre, komuniteti arbëresh krijoi dhe mbajti gjallë identitetin e vet kombëtar, i cili edhe sot pas 550 vitesh ruan me dashuri e fanatizëm gjuhën, kostumet, ritet, traditat dhe besimin. Ruajtja dhe kultivimi i identitetit kombëtar të arbëreshëve është një simbiozë unikale me integrimin e plotë të tyre me kulturën dhe shoqërinë italiane", - vuri në dukje Presidenti Meta. "Ne u jemi mirënjohës pafundësisht arbëreshëve për kontributin e çmuar që kanë dhënë për kombin tonë: përjetësimin e figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut ndër shekuj. Skënderbeu na bashkon të gjithëve ne shqiptarëve kudo në botë! Prandaj ne u jemi mirënjohës motrave dhe vëllezërve tanë arbëreshë që e ruajtën këtë figurë të lavdishme dhe bëmat e tij. Komuniteti arbëresh mbetet sot ruajtësi i vetëm i gjuhës që Skënderbeu dhe bashkëluftëtarët e tij patën folur gjashtëqind vjet më parë. Ky është një thesar i madh për kombin tonë, për Italinë dhe trashëgiminë botërore. Është në interesin e dy popujve dhe vendeve tona të promovojmë këtë komunitet të vjetër e me vlera unikale si pjesë e pandashme e trashëgimisë historike shqiptare, italiane dhe europiane", - u shpreh kreu i shtetit shqiptar. Presidenti i Republikës vlerësoi Kolegjin "Shën Adrianit" me Dekoratën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", "Në shenjë vlerësimi për veprimtarinë e çmuar akademike, për promovimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës arbëreshe, duke u kthyer në një vatër të rëndësishme të ruajtjes së trashëgimisë, të edukimit e formimit të të rinjve arbëresh. Me mirënjohje për kontributin e veçantë në forcimin e lidhjeve, veçanërisht kulturore, midis Shqipërisë dhe Italisë". Presidenti Meta dhe Presidenti italian Mattarella përuruan pllakatën kushtuar Heroit tonë Kombëtar, në të cilën janë gdhendur fjalët: "Në 550-vjetorin e përkujtimit të Gjergj Kastriotit, Skënderbeut". Meta gjatë vizitës në Kalabri u shoqërua edhe nga ministri për Diasporën,

Presidenti i italisë, Sergio Mattarella dhe homologu i tij shqiptar, Ilir Meta

TAKIMI
Presidenti Ilir Meta, në kuadër të vizitës zyrtare në Kalabri u takua me Ipeshkvin e Eparhias së Ungrës (Eparkia e Lungros), Hirësinë e Tij Donato Oliverio si dhe me autoritetet vendore e përfaqësues të bashkësisë arbëreshe, të cilët organizuan një pritje festive, me këngë dhe valltarë të veshur me kostume tradicionale arbëreshe.

"Vlerësim nga liderët e PPE, për betejën tonë"

Basha: PPE mbështetje për pastrimin e politikës nga krimi

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha gjatë takimeve që po zhvillon në Helsinki ka marrë mbështetje nga Partia Popullore Europiane për vetingun në politikën shqiptare. Lulzim Basha, mori pjesë dje në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të PPE. Në një postim në Twitter, z.Basha shprehet se ka marrë mbështetje dhe vlerësim nga liderët e PPE për pastrimin e politikës nga krimi. "Votimi për drejtuesit e PPE dhe rezolutat në Kongresin #EPPHelsinki. Pritet debati mes kandidatëve #alexstubb dhe #Manfredweber mbi vizionin tonë për Europën e vlerave. #up2EU Mbështetje dhe vlerësim nga liderët e EPP për betejën tonë për pastrimin e politikës nga krimi",-shkruan Basha. Partia Demokratike do të votojë për herë të parë një kandidat të PPE për President të Komisionit Europian. Votën e opozitës shqiptare në familjen e qendrës së djathtë Europiane e zbuloi dy ditë më parë në "Twitter" Lulzim Basha, i cili po merr pjesë në Kongresin e PPE në Helsinki. 4 votat e PD, kur të votohet të enjten, janë për gjermanin, Manfred Weber. "Në Asamblenë Politike të PPE #EPPHelsinki miratuam kandidaturat e Weber dhe Stubb. Nesër #EPPCongress debati dhe të enjten zgjedhim kandidatin e PPE për President të Komisionit Europian. Si anëtare me të drejtë vote, 4 votat e PD janë për @ManfredWeber e simotrës mike CDU/CSU", shprehet lideri i opozitës.

ASAMBLEJA
Kreu i PD-së, Lulzim Basha, mori pjesë dje në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të PPE. Në një postim në 'Twitter', z.Basha shprehet se ka marrë mbështetje dhe vlerësim nga liderët e PPE për pastrimin e politikës nga krimi.

Ruçi takon ambasadorin zviceran: Partner besnik i Shqipërisë

Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi priti dje ambasadorin e sapo akredituar të Zvicrës Adrian Maître. Gjatë takimit, Ruçi vlerësoi marrëdhëniet midis dy vendeve dhe mbështetjen që Zvicra i jep Shqipërisë. "Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Zvicrës janë të shkëlqyera. Zvicra është një partner besnik i Shqipërisë që nga viti 1992. Këto marrëdhënie mbështeten në miqësinë, respektin reciprok dhe bujarinë e dy popujve tanë", -tha Ruçi. Ky i fundit vlerësoi si mbështetjen e Zvicrës për zhvillimin dhe demokratizimin e Shqipërisë "Pritja nga Kryetari i Kuvendit është një nder për mua, institucioni i parlamentit është shumë i rëndësishëm për një vend demokratik. Ja pse ne po forcojmë bashkëpunimin me parlamentin shqiptar përmes një projekti që nis së shpejti bashkë me OSBE- dhe Institutin Demokratik Kombëtar (NDI)",-tha ambasadori zviceran Adrian Maître.

Zgjerimi i Unazës, PD: Aferë korruptive, 18 mln euro një kompanie guaskë

PD akuzon se tenderi për ndërtimin e Unazës së Re është aferë korruptive që i jep 18 milionë euro një kompanie guaskë me pronarë të panjohur. Sipas zëdhënëses, Ina Zhupa, tenderi në total 40 milionë euro ka fitues të paracaktuar me garë fiktive. "Faktet se pas rindërtimit të Unazës së re fshihet një afere korruptive janë disa: Kompania Dh Albania është krijuar në korrik të këtij viti, një muaj e gjysmë para hapjes së tenderit. Kompania mëmë e saj është kompani e regjistruar në parajsë fiskale, me pronarë të panjohur. Kompania Biba X ka nuk ka përvojë në ndërtim rrugësh, aktivitet të cilin e ka shtuar pak para së të shpallej fitues i tenderit. Kompania Biba X, sipas të dhënave të medias, ka qenë nën sekuestro edhe gjatë periudhës kur ka marrë pjesë në tenderin e Unazës së Re, në shkelje flagrante të ligjit të prokurimeve publike",-tha zj.Zhupa. Prej disa ditësh banorët kanë protestuar kundër prishjes së banesave për shkak të punimeve në Unazën e Re. Disa prej këtyre banorëve u shoqëruan nga policia në komisariatin numër 6, ndërkohë që paraditen e djeshme, për t'u interesuar për situatën në polici, shkuan deputetë demokratë Gent Strazimiri dhe Klevis Balliu.

Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C

Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C
-Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane **.Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leke.**

Data e shpalljes 11.09.2018
Data e zhvillimit 11.10.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

BUXHETI
RRUGËT

Ministri ka sqaruar se shteti s'mund të investonte 200 mln euro për autostradën

Tiranë-Durrës me pagesë, Gjiknuri: Do ketë edhe rrugë alternative

"23 miliardë lekë investimet për transportin rrugor"

Qeveria është e vendosur që autostradën Tiranë-Durrës ta japë me koncesion dhe kalimin me të ta bëjë me pagesë. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri deklaroi dje se një zgjidhje e tillë ishte e diktuar nga nevoja për investime të mëdha dhe të papërballueshme për buxhetin e shtetit në këtë rrugë. Gjatë raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese për buxhetin e vitit 2019, ministri Gjiknuri tha se autostrada Tiranë-Durrës do të jetë me pagesë dhe se ky koncesion do të shoqërohet me një investim të madh në këtë aks. "Që të zgjerosh këtë rrugë me paratë e buxhetit do të duhen mbi 200 milionë euro, gjë që ne nuk i kemi. Kështu që e vetmja alternativë mbetet të mobilizojmë kapitalin privat për ta bërë këtë të mundur. Një rrugë e cila vërtet do të jetë me pagesë, s'kemi pse ta fshehim". Ai siguroi se buxheti nuk do të marrë asnjë risk për këtë rrugë, pasi financimi do të jetë tërësisht privat.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri

KONCESIONI

"Që të zgjerosh këtë rrugë me paratë e buxhetit do të duhen mbi 200 milionë euro, gjë që ne nuk i kemi. Kështu që e vetmja alternativë mbetet të mobilizojmë kapitalin privat për ta bërë këtë të mundur. Një rrugë, e cila vërtet do të jetë me pagesë s'kemi pse ta fshehim".

RRUGA ALTERNATIVE

Ndërkohë që bëri të ditur se dhënia me koncesion e kësaj rruge do të shoqërohet me investime në rrugët alternative që shkojnë paralelisht me autostradën për të krijuar kushte sa më të mira lëvizjeje për qytetarët që nuk mund ta përballojnë vlerën e pagesës në autostradë. Sipas ministrit Gjiknuri, kalimi në rrugët alternative nga Tirana në drejtim të Maminasit, Shijak dhe nga Ndroqi në drejtim të bregdetit do të jenë pa pagesë. "Do të ketë rrugë alternative, pjesë e kësaj kontrate koncesionare të mundshme, të cilat do të jenë pa pagesë", - u shpreh Gjiknuri.

INVESTIMET

Ai bëri të ditur para deputetëve se rreth 23 miliardë lekë janë investimet buxhetore në vitin 2019 për transportin rrugor, ndarë në investime dhe mirëmbajtje. Segmentet kryesore që do të financohen me paratë e buxhetit janë 'by-pass'-et e Fierit dhe Vlorës dhe rruga Kardhiq-Delvinë. Por, sipas ministrit të Infrastrukturës, Damian Gjiknuri, buxheti i vitit 2019 realizon mbështetjen e nevojshme për kontratat e Partneritetit Publik Privat, për Rrugën e Arbrit, akset Thumanë-Kashar, Milot-Balldren dhe Orikum-Dukat. Ndërkohë, ai bëri të ditur që për të gjitha kontratat koncesionare, qeveria ka menduar që t'i supervizojë me kompani të njohura ndërkombëtare. "Ne kemi parashikuar dhe fonde për të marrë kompani ndërkombëtare të supervizimit inxhinierike, që do të thotë që të gjitha këto projekte do të supervizohen nga kompani të huaja", - tha Gjiknuri. Ndërkohë që nuk ka tërheqje nga ndërtimi i aeroportit të Vlorës. Sipas tij, nëse dështojnë negociatat me koncesionarin që ka shprehur interes, do të jetë buxheti, ai që do të financojë projektin.

Gjatë një seance parlamentare

"Unë jam absolutisht kundër që të shikohet dyshemeja"

Pagat deri 40 mijë lekë pa taksa, vendimin e merr seanca

Deputetë socialistë në Komisionin e Ekonomisë kërkojnë që pagat deri në 40 mijë lekë të reja të mos taksohen. Ata kanë propozuar që të rritet pragu nga 30 mijë që është sot, në 40 mijë lekë, si një zgjidhje që do t'u vinte në ndihmë afro 70 mijë personave që kanë këtë nivel pagash. Komisioni i Ekonomisë debatoi gjatë dje me ministrin e Financave, Arben Ahmetaj, pasi ky i fundit e kundërshtoi një propozim të tillë. Kështu, deputetja socialiste Blerina Gjylameti u shpreh se kjo nismë shkon në linjë me parimin që kush paguhet më pak, taksohet më pak dhe kush paguhet më shumë, taksohet më shumë. "Duke vlerësuar edhe rritjen e vazhdueshme të pagave të atyre që kanë marrë më pak deri tani dhe duke marr parasysh faktin që rritjet kanë prekur fashën, e cila nuk paguante dhe kanë kaluar në fashë që paguajnë, ne do duhet ta rishikojmë këtë duke propozuar që fasha për të cilën fillon tatimi mbi të ardhurat të jetë 40 mijë lekë dhe jo 30 mijë lekë sikundër e kemi", - tha Gjylameti. Ndërkohë që kryetari i komisionit, Erion Braçe theksoi se një propozim i tillë duhet të pranohet, pasi kështu favorizohet shtresa që ka më pak të ardhura. "Në qoftë se këtij vendi i ka ardhur e keqja në rritje borxhi, në rritje deficiti etj., nga tatimi i të ardhurave nga puna, atëherë unë dorëzohem", tha Braçe. Duke mos qenë dakord me këtë propozim, kreu i Financave renditi edhe arsyet. "Unë jam absolutisht kundër që të shikohet dyshemeja, absolutisht kundër, pastaj parlamenti të vendosë si të dojë. Është gabim fiskal. Do të thotë që nëse ju doni në të drejtën tuaj legjitime kush fiton më pak, paguan më pak dhe ky që fiton më pak paguan 1.9%, ju thoni nëse këtë fashë e nxjerrim fare, 9.6 mln nga buxheti i shtetit i kancelojmë dhe përfitokam edhe unë, edhe ti. Jo, s'do duhet", - tha Ahmetaj. Ndërkohë që fatin e këtij propozimi që ministri Ahmetaj e kundërshtoi do ta vendosë seanca plenare për buxhetin.

Socialistët, Kumbaros: Investimet, jo vetëm në Gjirokastër

Ndërsa opozita ka refuzuar të marrë pjesë në debatin për buxhetin e vitit të ardhshëm, kanë qenë vetë deputetët socialistë, ata që edhe pse në një mënyrë të moderuar kanë bërë oponencën e tij. Kjo u dje edhe në Komisionin e Medias, ku u diskutua buxheti i Ministrisë së Kulturës, ku deputetët e mazhorancës i kërkuan ministres të mos i përqendrojë investimet në Gjirokastër, aty ku është zgjedhur deputete, por t'i shpërndajë. "Në pikëpamjen e balancimit të investimeve kapitale duhet të kemi parasysh prioritetet, sepse në fund të fundit, edhe ne shkojmë në zonat tona dhe u referohemi të gjitha llojeve të investimeve", tha deputeti i Beratit, Fadil Nasufi. Ndërkohë që vetë ministrja Kumbaro u shpreh se një pjesë e mirë e investimeve janë përqendruar në ndërhyrjet në Muzeun Kombëtar dhe Galerinë e Arteve në Tiranë.

Agron Shehaj: Ulja e taksës, lëmoshë e Ramës

Për demokratët, paketa fiskale që ka paraqitur qeveria për miratim në Kuvend nuk është gjë tjetër, veçse një lëmoshë që sipas tyre Rama dhe Ahmetaj po bëjnë shqiptarëve. Sipas deputetit demokrat Agron Shehaj, ulja e taksave për ata që marrin nga 130 mijë deri në 150 mijë lekë të reja në muaj nuk sjell lehtësim më të madh se 1 mijë lekë në muaj. Në një status në "Facebook", Shehaj e quan "Paketa Fiskale nga Qytetarët te Oligarkët" dhe thotë se pas dyfishimit të taksave për shumicën e shqiptarëve, Rama ka vendosur të japë lëmoshë. "Ahmetaj tallet me qytetarët. 1 mijë lekë në muaj është ulja mesatare e taksave dhe vlen vetëm për individët që e kanë rrogën nga 130.000 në 150.000 në muaj. Pasi Rama vendosi të rrisë taksat nga 10% me 23%, dyfish më shumë se gjitha vendet e rajonit, tani ka vendosur t'u ofrojë një lëmoshë. Sipas Paketës Fiskale "nga Qytetarët tek Oligarkët", tatimi 23 % do vendoset për pagat mbi 150 mijë lekë. Ata që marrin pak më shumë se 1000 euro në muaj do kursejnë vetëm 1 mijë lekë në muaj mesatarisht. Mbi 100 euro do të ishte përfitimi për këta qytetarë, nëse do aplikohej taksa e sheshte prej 9%. Ky përfitim është shumë herë më i madh sesa ofron sot Rama dhe Ahmetaj me 1 mijë lekë", shkroi Shehaj.

Rikonstruksioni i ambienteve të Kryesisë, 41 milionë lekë për ndërtimin e një kanali TV

Shpenzimet e Kuvendit, 355 mln lekë për "blerje autoveture"

Parlamenti do të prodhojë sinjal televiziv për mediat

Ndonëse një periudhë e shtrëngimit finan ciar, blerja e automjeteve mbetet një nga kërkesat më të shpeshta nga institucionet shtetërore, thuajse në çdo buxhet që paraqitet për miratim. Përjashtim nga kjo nuk bënë as Kuvendi i Shqipërisë, i cili në buxhetin e tij për vitin 2018 kishte parashikuar një zë të veçantë "blerje autoveture" në vlerën e 355 milionë lekëve. Është vetë Shërbimi i Financës dhe Buxhetit në Kuvendin e Shqipërisë, ai që në relacionin mbi zbatimin e buxhetit të këtij institucioni për 4-mujorin e parë të këtij viti bën të ditur ndër të tjera dhe fondin e parashikuar për "blerje autoveture" në vlerën e 355 milionë lekëve. Në këtë relacion, siç shihet edhe në tabelën shoqëruese, nuk jepen shpjegime nëse bëhet fjalë vetëm për një autoveturë apo për disa të tilla, ndonëse nga mënyra e përkufizimit të zërit në këtë buxhet "blerje autoveture" lë të kuptohet se bëhet fjalë vetëm për një automjet. Ndërkohë që burime nga Kuvendi kanë pohuar se bëhet fjalë për 3 ose 4 automjete. Në faqen zyrtare të Kuvendit nuk janë publikuar të dhëna të tjera lidhur me procedimin e kësaj blerje të parashikuar në buxhetin e Kuvendit, ndërsa ajo që dihet është se ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e këtij institucioni edhe në vitet e mëparshme, blerja e një automjeti për titullarin. Një kërkesë e tillë daton që nga periudha kur Kuvendi drejtohej nga Jozefina Topalli, por që për shkak të problemeve financiare, nuk ishte realizuar.

KANALI TELEVIZIV

Një tjetër zë i parashikuar në buxhetin e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2018 ishte edhe "projekt për ndërtimin e një kanali televiziv". Sipas relacionit të Shërbimit të Financës dhe Buxhetit në Kuvend, fondi i parashikuar në buxhetin e këtij institucioni kap vlerën e 43 milionë lekëve. Në fakt, bëhet fjalë për një projekt të paralajmëruar edhe më parë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe kryeministri Edi Rama dhe që ka për qëllim që t'u ofrojë lehtësira mediave të ndryshme që të marrin nga një regji e posaçme sinjalin e transmetimeve të seancave plenare dhe komisioneve parlamentare. Rreth një vit më parë Kuvendi e cilësoi projektin si një zgjidhje përfundimtare që do t'u sigurojë mediave aksesin viziv për seancat plenare. Ndonëse disa media në atë kohë e kundërshtuan këtë projekt për shkak se ai mund të cenojë lirinë e tyre për të marrë vetë pamjet dhe informacionin direkt nga seanca dhe komisionet, projekte të ngjashme janë të pranishme thuajse në shumicën e parlamenteve të vendeve të Bashkimit Europian.

Artikulli/Kod	Projekti	ZERAT	Buxheti Viti 2018	
			Plan	Realizuar 4 mujori parë
230	M020050	Projekt rikonstruksion ambjentet bodrum	200.000	0
230	M020006	Projekt-rikonstruksion ambjente parku	200.000	0
230	M020051	Projekt-rikonstruksion te rrjetit elektrik	800.000	0
231	M020037	Sistem i mirëpërhmit dhe administrimit te dokumentacionit	18.600.000	0
231	M020044	Blerje system sigurie për e- mail	1.800.000	0
231	M020045	upgrade për pajisjen San storage	1.500.000	0
231	M020046	Platforme online ndërinstitucionale	4.500.000	0
231	M020014	Blerje aplikacion "Kuvendi i Shqipërisë"	3.750.000	0
231	M020047	Blerje system sigurie per internetin	1.500.000	0
231	M020029	Fondi librit	352.000	0
231	M020004	Blerje autoveture	35.500.000	0
231	M020043	Sherbim konsulence per kendin historik	800.000	0
231	M020054	Krijim " press point"	800.000	0
231	M020002	Blerje pajisje per Kuvendin	28.157.000	1.207.200
231	M020048	FV i nje vendgendrimi per gazetaret	700.000	0
231	M020035	TVSH Projekt IPA	8.400.000	5.014.202
231	M020049	Projekt për ndërtimin e një kanali televiziv	4.331.000	0
231	M020001	Rikonstruksion ambienteve të Kryesisë (bodrum)	10.600.000	0
231	M020055	Rikonstruksion Sistem i mbrojtjes nga zjarri	1.330.000	0
		TOTALI	124.000.000	6.221.402

Faksimile e relacionit rezulton në një përqindje të ulët si rezultat i planifikimit për

TELEVIZIONI

Bëhet fjalë për një projekt të paralajmëruar edhe më parë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe kryeministri Edi Rama dhe që ka për qëllim që t'u ofrojë lehtësira mediave të ndryshme që të marrin nga një regji e posaçme sinjalin e transmetimeve të seancave plenare dhe komisioneve parlamentare.

Deputetët, kritika Ministrisë së Brendshme: Policia s'ka makina

Ndërsa Kuvendi ka planifikuar buxhetin aktual që të shpenzojë 335 milionë lekë për makina, duket se situata në disa institucione të tjera është vërtetë problematike në këtë drejtim. Një prej tyre është edhe Policia e Shtetit. Ndërsa vetë përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme teksa raportuan në Komisionin e Sigurisë se nuk kishin objeksione lidhur me buxhetin e parashikuar për vitin e ardhshëm, ishin deputetët socialist ata që ngritën shqetësimin se në disa komisariate dhe posta policie nuk kanë mjete për të kryer detyrat e tyre të përditshme për kontrollin dhe sigurinë e rendit në territorin që mbulojnë. Kështu në Cërrik apo në Selenicë, ku ndodhi tragjedia me 8 të vrarë në gusht, policia ka vetëm një makinë në përdorim. "Në Komisariatin e Cërrikut ka vetëm një makinë në gjendje pune. A ka fonde për rregullim, si mund të funksionojë kështu?", tha Luan Duzha, deputet i PS-së. "Atje policët kanë shumë vështirësi, nuk e di me një makinë dhe aq pak forca", tha Vullnet Sina, deputet i PS-së. Buxheti i Ministrisë së Brendshme është rritur me 1% për vitin 2019, me një shifër që kap 21 miliardë lekë, ose e thënë ndryshe 210 milionë dollarë, duke u renditur një nga dikasteret që merr më shumë para nga buxheti i shtetit.

Xhaçka "kursen" miliona euro, ushtria ndërton argjinaturën e Vjosës

Forcat e Armatosura, të mbështetura nga Bashkia Fier po forcojnë argjinaturën e lumit Vjosa, duke rehabilituar në pak javë 3.5 kilometrat e parë. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka duke inspektuar punën që po bëhet theksoi se projekte të tilla jo vetëm reduktojnë fatura e mëdha në raste emergjencash, por në të njëjtën kohë vendosin një standard të ri në parandalimin e pasojave që mund të sjellë moti i keq. "Zbatimi i këtij projekti, i cili në kushte të tjera do të kishte kushtuar miliona euro, falë profesionalizmit dhe përkushtimit të FA do të kushtojë shumë herë më pak. Ka ardhur koha që nën shembullin e Fierit dhe të këtij projekti të mirë koordinues mes të gjithëve ne, të vendosim një standard të ri në menaxhimin e emergjencave përmes nismave që parandalojnë pasojat e motit të keq", tha Xhaçka. Xhaçka bëri me dije se Ministria e Mbrojtjes është në procesin e rishikimit të ligjit për Emergjencat Civile, ligji i cili pritet të përcaktojë detyrimet për secilën strukturë, si dhe penalitetet e nevojshme për strukturat dhe personat që neglizhojnë apo nuk respektojnë detyrimet ligjore.

"Çdokush mund të të hapë punë, nëse nuk i jep shërbimin"

Rama: Presioni ka sjellë ndryshim të madh në administratë

Në takimin e përjav shëm me qytetarët për platformën e bashkëqeverisjes, kryeministri Edi Rama bëri të ditur se është rritur numri i rasteve të zgjidhura për problemet dhe ankesat që kanë raportuar qytetarët. Ai u shpreh se falë presionit të ushtruar nga platforma është rritur efikasiteti i shërbimit ndaj qytetarëve. "Presioni ka sjellë një ndryshim të madh në administratë. Na vjen shumë mirë po ashtu që në tërësinë e tyre, qytetarët shprehen të kënaqur dhe janë të gatshëm për të ardhur këtu dhe shprehur shqetësimin dhe zgjidhjen që kanë gjetur", tha Rama. Ndërkohë që një qytetar tregoi para kryeministrit se kishte gjetur zgjidhjen pas adresimit të problemit në platformën e bashkëqeverisjes. "Unë kam ndërtuar një shtëpi në tokën private në 1997, deklarimi është bërë dy herë në vitin 2000 dhe 2005. Tani s'kam ç'të them më tepër, sepse problemi është i qartë. Dua të falënderoj edhe stafin e platformës, të cilët janë tepër korrektë në përcjelljen dhe zgjidhjen e problemeve", tregoi qytetari. Duke iu referuar pikërisht këtij rasti, kryeministri theksoi se në administratën publike falë kësaj platforme po krijohet bindja çdo ditë e më shumë çdo kërkesë që vjen në sportele duhet zgjidhur. "13 vite të humbura për një punë që donte vetëm 10 ditë që të kryhej. Më vjen mirë që informoj edhe publikun që na ndjek që po vihet re një statistikë në rritje në rastet e zgjidhura. Ka filluar të mbillet në administratë fara e vetëdijes se çdokush që vjen për shërbim, mund të të hapë punë nëse nuk ia jep atë shërbim", theksoi Rama.

ZGJIDHJA

"Presioni ka sjellë një ndryshim të madh në administratë. Na vjen shumë mirë po ashtu që në tërësinë e tyre, qytetarët shprehen të kënaqur dhe janë të gatshëm për të ardhur këtu dhe shprehur shqetësimin dhe zgjidhjen që kanë gjetur".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË', VOLUMI 1, FAQJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPËRFAQJE 4.453 m2, NË ADRESËN: XHAFZOTAJ, DURRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,

ÇMIMI 12.468.400 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 30.11.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Mjekësia ligjore përcolli trupin në Gjirokastër, situata

- Strong commitment to perform and to deliver results, good self-management, solution oriented mind-set and eager to deal with new initiatives;
- Enjoy working in fast-paced, challenging and international environment

Location: DHP Tirana Offices
Starting Date: February 2019
Devoll Hydropower offers:

- Professional and personal development in an exciting company
- A positive working environment characterized by competence, responsibility and innovation
- A diverse workplace with regard to gender, age and cultural background
- Competitive terms of employment and excellent benefit schemes

Interested candidates are invited to submit their CV's under the email address:

d.marko@pendlpiswanger.com until latest 25/11/2018 with referential code **104/638**

Statkraft is a leading company in hydropower internationally and Europe's largest generator of renewable energy. The Group produces hydropower, wind power, solar power, gas-fired power and supplies district heating. Statkraft is a global company in energy market operations. Statkraft has 3500 employees in 17 countries



Libri për fëmijë, që vjen nga realiteti për të cekur një problematikë të madhe

Rovena Rozhani:

"Lëndina e arushëve", thirrje urgjente për të rigjetur lidhjen e njerëzve me natyrën

"Më zemërojnë kafazet ku mbyllen kafshët"

Egla Xhemali

Natyra e të shkruarit që ajo ka zgjedhur është paksa e vështirë, pasi u dedikohet fëmijëve. Një proces delikat, por që ta mbush shpirtin plot me kënaqësi. Rovena Rozhani, autorja e disa librave për fëmijë vjen në një rrëfim për "Gazeta shqiptare" për të hedhur dritë mbi "Lëndina e arushëve". Autorja na zbulon se nga ka ardhur frymëzimi për të shkruar këtë përrallëz me në qendër arushin Tomi, për të vazhduar pastaj me motivet, risitë dhe mënyrën se si gazetaria e ka ndihmuar me hulumtimet letrare. Kërkuesit e zellshëm të librave për fëmijë e sidomos prindërit vënë re se magjia e një libri të shkruar për të vegjlit e tyre ka të bëjë me mënyrën e të rrëfyerit. Në librin e autores, përveç fabulës së veçantë, vihen re fjalitë e shkurtra e dialogët e saktë, që të fusin në "kurthin" e botës fëminore, që të bëjnë të përjetosh gëzimet dhe trishtimet e arushëve të futur në kafaz nga njeriu. I përjeton njësoj si të jesh një fëmijë i futur vetë në kafaz. Në këtë libër që mund të lexohet edhe nga të rriturit, Rozhani i bashkohet atij grupi të vogël të shkrimtarëve shqiptarë, atyre që iu rrëfejnë me shumë dashuri rrëfime plot jetë dhe energji fëmijëve. Prandaj shkrimtarja ka vendosur t'u rrëfejë fëmijëve një fenomen që e ka parë me sytë e saj, atë të robërimit të arinjve. Gjithçka e trajtuar bukur dhe rrjedhshëm. Ndër faqe kridhemi në botën e fantazisë që ka indicie nga realiteti. Për të gjithë prindërit, Rovena Rozhani jep kështillën që të lexojnë sa më shumë me fëmijët, pasi kështu forcojnë edhe më shumë lidhjen mes tyre.

"Lëndina e arushëve", libri që desha ta shkruaj që kur pashë Tomin në kafaz

Të shkruash letërsi për fëmijë është e vështirë, duke marrë parasysh moshën delikate të tyre. Çfarë risie i keni sjellë kësaj letërsie me "Lëndina e arushëve"?

Unë e quaj letërsinë më të vështirë. Leximi është i lehtë, i këndshëm, i bukur, por shkrimi i kësaj letërsie është një sfidë më vete dhe kushdo që ka provuar, ia ka ndjerë shijen e fortë. Sa i përket risisë së këtij libri, mund të them se është një rrëfim që vjen nga realiteti. Sigurisht, është i mbushur me shumë ndjenja të forta, aventura të papritura dhe një gjuhë plot figura. Por, mbi të gjitha është i mbushur me shumë dashuri. Kur e shkruaja, më dukej sikur titroja një film. "Lëndina e arushëve" ka një tematikë mjedisore, një temë që nuk e ndesh në letërsinë shqipe për fëmijë, por që jashtë vendit është mjaft e lëvruar, ashtu si edhe shumë botime specifike që trajtojnë problematika, apo fenomene të veçanta. Dhe ashtu siç është një libër me temë të veçantë, ashtu përkoi edhe promovimi i tij. Në atmosferën e kafshëve të kopshtit zoologjik në Fier, që u zhvendosën në Tiranë, në një ndjesi që thërret për ndryshim dhe reagim. Është një temë që i ftON të gjithë të shohin ndryshe marrëdhënien e tyre me kafshët. Një histori që nëpërmjet fëmijëve synon të shkojë te të rriturit për të dëshmuar se gjithçka duhet lënë aty ku natyra i ka bërë vend. Imazhet e arinjve apo kafshëve të lidhura për fotografi, apo të mbyllura në kafaze, ku u jepet raki e birrë apo ushqime çfarëdo, të keqtrajtuara duhet të marrin fund. Por, mbi të gjitha është një thirrje urgjente për të rigjetur lidhjen e njerëzve me çdo element të natyrës. Kur jemi të lodhur nga puna dhe rutina, sa shumë e duam një udhëtim në natyrë! Sa qetësi gjejmë dhe sa shumë kërkojmë nga natyra, te kafshët, zogjtë, por sapo qetësohemi, harrojmë dhe u biem ndesh. Risitë e tjera të "Lëndinës" ia lë kritikës, që të shprehen për vlerat letrare të këtij libri dhe siguristh lexuesve, nga të cilët pres me padurim reagimet.

Cilat janë motivet kryesore që e frymëzuan këtë libër?

Arushët. Të bukurit arushë të murrmë, që janë personazhe në shumë përralla, por për fat të keq janë edhe protagonistët e kronikave të sotme. Tomi, Xhina, Pashuku e arushë të tjerë janë pjesë e një fenomeni të shëmtuar në Shqipëri, por edhe në vende të tjera. Kam dashur ta shkruaj këtë libër që kur kam parë Tomin, arushin e trishtuar që pushtoi mediat e huaja për fatin e tij brenda një kafazi lokali. Pastaj e ndoqa fenomenin nga afër edhe për shkak të punës. Mësova shumë gjëra që nuk i dija, ashtu si shumë të tjerë. Mësova që këta arinj nuk mund të kthehen më në habitate, pasi janë shkëputur nga jeta e tyre. Një udhëtim me gazetarë në Pyllin e Arinjve në Prishtinë, të fondacionit "Katër Putrat", ku ishin mbledhur arinj të çliruar nga robëria, ishte një shkundje për të gjithë që panë me sytë e tyre një realitet të shpërfillur, ndoshta nga problemet e mëdha të këtij vendi, ndoshta nga padija, apo ndoshta sepse kurrë nuk kishim ndalur të pyesnim apo të mendonim sesa vlen një selfie me një arush të mbyllur në kafaz. Dikur më trishtonin këto kafshë të mbyllura, ndërsa sot më zemërojnë kafazet. Puna në ministri ka filluar të japë frytet e para në mbrojtje të këtyre arinjve, por siguristh që ka akoma më shumë për të bërë. Sidomos në mentalitetin e njerëzve. Këtu shpresoj të ndryshoj diçka me këtë libër.

Për çfarë keni qenë e kujdesshme gjatë shkrimit të librit?

Jam përpjekur shumë për gjuhën, pastërtinë e gjuhës standarde për të mbajtur leximin dhe fjalorin larg ligjërimit të sotëm, zhargoneve dhe shpesh përçudnimeve nga përdoruesit. Dhe jam kujdesur të ruaj nivelin e gjuhës për fëmijë, por sidomos elementët e natyrës kam dashur t'i përfshij pa kufi. Për mua natyra është e gjitha një qenie. Gjithashtu, edhe linjat e historisë, të cilat shpesh donin të dilnin jashtë kufijve dhe më duhej t'i riktheja në shinat e duhura. Nëse do të kisha shkruar variantin e parë të historisë, natyrisht që nuk do të ishte një libër për fëmijë, por një dramë e fortë që do të kishte shkundur të rriturit. Por, ky variant i botuar më duket edhe më i bukur, sepse tregon shpresën dhe rëndësinë e njeriut në fatin e kafshëve. Dhe përtej kuptimit të parë, libri është një rrëfim për familjen, vendlindjen, dashurinë dhe miqësinë. Ndaj jam kujdesur që psikologjikisht ky libër të ishte sa më i saktë, ndaj ia kam besuar gjykimit të dr. Blerta Bodinakut. Nga pikëpamja letrare, kumbara e librit është shkrimtarja e njohur e letërsisë për fëmijë, Adelina Mamaqi.

Cilës grupmoshe i sugjerohet "Lëndina e arushëve"?

Grupmosha është nga 6-10 vjeç, por të them të drejtën kam parë edhe fëmijë më të rritur që e kanë lexuar. Madje edhe të rritur. Të gjithë i duan përrallat. Mbaj mend një orë letrare në shkollën e Pishkashit, rreth 5- 6 vjet më parë. E kisha konceptuar si një orë leximi jo vetëm të asaj çfarë shkruaja, por edhe të krijimeve të nxënësve. Përralla "Pulat shkojnë në plazh" ishte botuar në revistën "Mrekullia" dhe unë e kisha shumë për zemër që ta lexoja me ciklin e fillores. Por për shkak të një ngatërresë, m'u desh ta lexoja para një klase të 8-të. Çfarë djersësh të ftohta më kaluan! Por nuk kisha asnjë zgjidhje. Ula sytë në tekst dhe lexova pa guxuar të ngrija kokën. Për çdo situatë komike dëgjoja të qeshura dhe në fund duartrokitje. Ngrita kokën dhe pashë se disa prej nxënësve ishin mbështetur mbi banka dhe dukej sikur donin që leximi të mos mbaronte. Pastaj filluan të lexonin vjershat e tyre. Edhe "Lëndina e arushëve" ka pasur lexime të suksesshme nga të rriturit.

Pse keni vendosur të shkruani për fëmijët?

Sepse ndihem shumë mirë. Sepse që e vogël më ka pëlqyer t'u mësoj më të vegjëlve, të kujdesem për ta dhe të krijoj për ta. Janë pjesa më e mirë, më e bukur, më delikate dhe më e sinqertë e shoqërisë. Janë e djeshmja jonë, fëmija që e humbim ose e harrojmë brenda vetes.

Nga bota e letërsisë për fëmijë, ka pasur ndonjë autor që i jeni referuar para se të nisnit shkrimet tuaja?

Fëmijëria ime e paraviteve '90 nuk linte vend për zgjedhje, por unë i kam dashur dhe lexuar të gjitha botimet që më binin në dorë, qofshin libra shqiptarë apo të huaj. I lexoja dhe rilexoja, sidomos librat me aventura, të gjitha përrallat dhe rrëfenjat folklorike. Nuk dua të veçoj asnjë prej tyre, sepse çdo libër ka qenë një udhëtim më vete, unik, i papërsëritshëm nga një titull të tjetri, nga një shkrimtar te tjetri.

Sa ju ka ndihmuar gazetaria në raport me hulumtimet letrare?

Gazetaria të mpreh syrin dhe mendjen. Ajo më ka falur vëzhgimin deri në detaje. I kam dashur shumë detajet edhe kur lexoja libra që në fëmijëri, por kur vëzhgimi bëhet profesion, të duket sikur mendja është gjithmonë zgjuar dhe gati të përthithë çdo gjë rreth e rrotull. Në përgjithësi e gjithë përvoja ime në punë, edhe kjo në zyrën e shtypit në Ministrinë e Mjedisit më ka krijuar një mundësi për të parë gjërat ndryshe. Në kinema "Millennium", ku për vite me radhë isha zëdhënëse, kam parë anën tjetër të botës së kinematografisë, artistëve, filmave, produksioneve dhe përgatitjes së premierave të para, që më pas u kthyen në modë. Të gjitha këto dikur i shikoja thjesht si gazetare. Në punën time aktuale shoh anën tjetër të gazetarisë sociale, ku pata edhe fillimet e mia në këtë profesion. Kur kthej kokën pas, në përvojën e shkurtër jetësore kuptoj se asnjë sekondë e jetës nuk ka vajtur dëm. Edhe qëndrimet në vend, edhe prapakthehut, edhe drejtimet e tjera që nuk i kisha menduar ndonjëherë, të gjitha kanë lënë gjurmën e tyre tek unë. Koha i bën me vlerë të gjitha momentet e jetës.

Cilës i jepni përparësi, fantazisë apo realitetit?

Unë i dua të dyja dhe përparësitë ua lë t'i vendosin vetë, mes tyre. Por besoj se nuk ka një letërsi të mirë apo një art të mirë nëse nuk ka një bazë realiteti, nëse nuk ka të vërtetën artistike. I gjithë realiteti që ti jeton shndërrohet dhe vesh kostumin e vet të fantazisë gjatë procesit krijues.

Kështilla juaj për prindërit që u zgjedhin libra fëmijëve?

Për prindërit është e vështirë të zgjedhin librat, sepse tregu në Shqipëri është shumë kaotik nga tranzicioni i gjatë jo vetëm shoqëror, por edhe shpirtëror. Sistemet e vlerave janë çoroditur dhe jo vetëm në art. Por, unë do t'u thosha që brenda mundësive të lexojnë vetë librin dhe të shohin me kujdes gjuhën, por edhe trajtimin e temave. Duhet të zgjedhin librat sipas moshës ose sipas zhvillimit të fëmijës. Por ajo që ka më shumë rëndësi është që duhet të lexojnë sa më shumë me fëmijët, duhet të rrëfejnë mbrëmjeve historitë, përrallat, të krijojnë bashkë me fëmijët, të bashkëbisedojnë edhe pse mund të jenë shumë të lodhur nga punët e ditës. Të jenë të bindur që kur të lexojnë një përrallë, edhe vetë do të qetësohen e do të flenë më të qetë. Kështu afrojnë fëmijët me librat dhe forcojnë lidhjen prindër-fëmijë. Libri është një formë e shkëlqyer e shprehjes së emocioneve, ndjenjave, një portë e mirë për komunikim dhe në kohët e sotme kur komunikimi po përfundon në nivel teknologjik, leximi është shpëtim, ushqim shpirtëror.

INTERVISTA
SPECIALE

Intervistë e mjekut të famshëm të kardiologjisë, dhënë për emisionin 'Rrëfim' në TV 'Scan'

Dr. Spiro Qirko: Si shërbeu gjyshi im, Athanasi, për 57 vjet si mjek në Vlorë

Dëshmia: Babai im, Telemaku, u diploma në Lozanë të Zvicrës dhe pasi punoi tre vjet në Kombet e Bashkuar, u kthye për të shërbyer përgjithmonë në Shqipëri

Para disa ditësh, mjeku i famshëm, Prof. Dr. Spiro Qirko, një nga emrat më në zë të kardiologjisë shqiptare, ishte i ftuar në Tv Svan, në emisionin 'RREFIM', i cili prej tre katër vjetësh realizohet nën drejtimin e gazetarit të njohur, Dashnor Kaloçi, si autor, dhe moderohet nga gazetarja Albana Shehu Qirjako. Në këtë emision ku prej vitesh kanë qenë të ftuar emra dhe personazhe nga më të njohurit e politikës, artit, kulturës, sportit etj. etj., dr. Qirko rrëfeu për më shumë se 90 minuta historinë e panjohur të jetës dhe familjes së tij, nga babai dhe nga nëna, duke filluar nga gjyshi, Athanas Qirko, i diplomuar në Paris për Mjekësi, te babai, Telemak Qirko, i diplomuar në Itali dhe Zvicër për Jurisprudencë, e deri tek vetë profesori i njohur, i diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe i specializuar në Francë në vitet '70-të. Si dhe historinë e familjes nga nëna e tij, (familja Leka nga Durrësi), ku për katër breza me radhë kanë qenë të gjithë intelektualë të njohur në fusha të ndryshme, si në Mjekësi e Jurisprudencë, të gjithë të diplomuar jashtë Shqipërisë. Po kështu, Dr. Qirko rrëfen për herë të parë edhe shkollimet e tija nga klasa e parë e më tej deri në fakultet, duke kujtuar mjaft nga profesorët e tij të gjimnazit etj., si dhe ata që e ndihmuan dhe i dhanë mundësinë për t'u specializuar në Francë në vitin 1975, ku atë e lutën për të qëndruar përgjithmonë me punë aty. Për më shumë rreth kësaj dhe të tjera histori dhe ngjarje interesante nga jeta e tij, na njeh intervista e kolegës sonë, Albana Shehu Qirjako, e cila vazhdon në tre numra radhazi në 'Gazeta Shqiptare'.

Përshëndetje të dashur miq, ditët kanë kaluar dhe ia kanë lënë vendin njëra- tjetrës, ne jemi takuar sërish në rrëfimin tonë të fundjavës ku sërish kemi të ftuar një personazh mjaft interesant, ashtu siç kemi bërë gjithnjë nuk do e tregojmë se cili është. Fillimisht do ju tregojmë një foto të fëmijërisë së tij...Të nderuar miq kam kënaqësinë që në studio të kem një personalitet i fushës së mjekësisë, një mjeshtër i madh, Profesor Doktor Spiro Qirko. Kënaqësi doktor që ju kemi këtu...

Edhe unë jam shumë i lumtur që jam në studion tuaj...

Profesor, do ju ngacmojmë në kujtimet tuaja, ju keni dalë në media, në fakt, dhe keni folur për punë tuaj, për arritjet tuaja, për ato çfarë i shqetëson njerëzit, gjë të cilës ju i jeni përkushtuar, por sot do ju ngacmoj pak në karrierën dhe në jetën tuaj personale bashkë me atë profesionale të ndërthurura, do ju çojmë vite larg. Ju keni lindur në qytetin e Tiranës, por, në fakt, origjina juaj nuk është nga Tirana...?

Kam lindur në Tiranë në vitin 1944, në Maternitetin e Tiranës dhe nëna ime e kishte shumë dëshirë që të më fotografonin dhe unë ruaj një fotografi ku kam dalë i sapolindur. Ajo e donte edhe si kujtim, por edhe që ta kishte dhe të shikonte evolucionin tim gjatë viteve, ashtu si çdo të donte çdo nënë. Natyrisht që është një kujtim i veçantë, është një fotografi e vjetër, por që unë e ruaj me shumë kujdes në albumin tim dhe që i referohem gjithmonë për të parë evolucionin që ka bërë një njeri që në atë moshë e më pas. Por sido që të jetë, ajo fotografi më inkurajon, më jep kënaqësi, jam një fëmijë i shëndetshëm aty, për fat nuk kam pas problem aty dhe as në rininë time. Në sajë të kujdesit të prindërve u rrita si një fëmijë i shëndoshë dhe kjo pastaj më dha të mundësitë që të përballoj të gjitha sfidat e jetës që vijojnë më pas.

Shumë emocionuese doktor të flasësh për atë kohë?

Eshtë vërtetë moment emocionues të flasësh për jetën, sepse jeta e njerëzve është komplet e ndryshme pavarësisht se nga struktura anatomike njerëzit janë të barabartë dhe trajektoret e jetës janë krejtësisht të ndryshme dhe kjo e bën dhe më interesante jetën. Eshtë një jetë e mbushur me mistere dhe të papritura me suksese dhe dështime, por duhet shkuar përpara. Pra, gjithmonë duhet të ecim përpara. Kam parasysh një thënie të Martin Luter Kingut, i cili ka thënë dhe që është një porosi për të gjithë njerëzit: "Mundohu të fluturosh, në qoftë se nuk fluturon, mundohu të vraposh, në qoftë se nuk vrapon, mundohu të ecësh, në qoftë se nuk ecën, mundohu të kacavirresh, por në fund vazhdimisht duhet të ecësh përpara. Kjo është jeta njerëzore dhe që duhet të karakterizojë të gjithë njerëzimin dhe gjithsecilin nga ne për të qenë të suksesshëm për këtë periudhë që jetojmë. Dhe kjo e Martin Luter Kingut është një kryevepër nga ato lexime që kam parë. Më është dukur vërtet shumë optimiste dhe shumë inkurajuese. Sepse ne të gjithë gjatë jetës kemi pasur problemet tona, kush më shumë dhe kush më pak. Nuk ka qenë kurrë një trajektore pa vuajtje. Eshtë një shprehje e moçme shqiptare që më ka impresionuar gjithmonë dhe që unë nuk e harroj kurrë, që thotë: "Jeta nuk është gjë tjetër vetëm një vrapim me pengesa nga materniteti në varreza". Dhe ne jemi të detyruar që të kalojmë pengesat që të ndjejmë kënaqësinë e jetës. Sigurisht edhe mua më kanë shoqëruar këto fenomene gjatë jetës, gjatë një jete jo fort të lehtë, por të ndërlikuar, por duke pasur parasysh këtë ide të madhe të Luter Kingut, që ne duhet të ecim, të vrapojmë, dhe kur biem, të ngrihemi dhe të ecim, të shkojmë përpara dhe aty të arrijmë suksesin.

Familja juaj si nga nëna ashtu dhe nga babi vijnë nga familje shumë të njohura dhe me tradita, gjyshi juaj nga babai ka qenë mjek...?

Unë origjinën e gjyshit tim, Athanas Qirko, ose Nasho siç e thërrisnin, e kam nga Narta e Vlorës. Ai pasi arriti moshën për të studiuar, shkoi në gjimnazin "Zosimea" të Janinës, ishte një ide e babait të tij, pra e stërgjyshit tim që fëmijët mos t'i linte në fshat që të merreshin me ullinjtë, me peshk dhe ato që krijonte fshati, por ishte ideja dhe mendonte që kishte ardhur koha që ato të shkolloheshin. Unë mbaj mënd një episod që ma ka treguar gjyshi im, që kur ishte i vogël e mori babai i tij dhe e çoj në arë aty që t'i tregonte: "Tani, o do zgjedhësh këtë punë, o do shkosh në shkollë". Në fakt, ai u tmerrua, se ju futën gjembat në këmbë nga puna e rëndë dhe i tha; "Jo baba, unë do shkoj në shkollë".

Një stërgjysh shumë i mençur...?

Po, një stërgjysh shumë i mençur, me thënë të drejtën, këtu fillon dhe zanafilla e familjes tonë, dhe unë mendoj që po mos të ishte ai, pra po të mos shkollohej ai, nuk do të ishim ne të tjerët në ato vende ku kemi qenë dhe jemi. Dhe gjithmonë lutem aty ku është që shpirti i tij të jetë i ndriçuar. Në fakt në atë kohë ishte një sakrificë e madhe nuk ishte e lehtë të dërgoje fëmijët të studionin jashtë, sepse nuk kishte të ardhura maksimale. Sepse prodhoheshin një herë në vit dhe gjyshi më tregonte se nga shitja e prodhimeve, paratë që fitonte ja jepte të gjithë njëherësh për gjithë vitin. Dhe ai shkoi në "Zosimea", i cili ishte një nga gjimnazet e famshëm ku ka qenë dhe Naim Frashëri dhe njerëz të tjerë jo pak figura të shquara të Shqipërisë dhe greke, gjithashtu. Dhe pastaj pasi mbaroi "Zosimean" ai shkoi në Universitetin e Athinës, ku mbaroi për Mjekësi. Dhe Mjekësinë në Athinë kështu e ka bërë, pra një pjesë të parave ia dërgonte i ati dhe një pjesë tjetër e siguronte duke punuar si infermier në mënyrë që të siguronte shpenzimet që i duheshin.

Pra, me shumë sakrifica....?

Po me shumë dhe kështu mbaroi studimet dhe u diplomua në vitin 1900. Nga viti 1900 deri më 1957 gjyshi Athanasi ka ushtruar profesionin si mjek në Vlorë. Ai ishte mjek shumë human, shumë i zoti, misionar dhe i përkushtuar. Duhet të kuptojmë se në atë kohë nuk kishte mjek, gjyshi ishte pediatër, pra i specializuar kryesisht në Pediatri, por në kohën e atëhershme në Vlorën e atëhershme, duhet t'i bëje të gjitha. Pra, gjyshi ishte një mjek i përgjithshëm, ai ishte dhe gjinekolog, ishte dhe otorinolog dhe otojatër dhe okulist. Po të shikojmë, unë kam në shtëpi disa kujtime të tija, kam dhe një forceps që nxjerr fëmijët e sapolindur. I kam se i ka ruajtur ai vetë, pra atij i duhet t'i bënte të gjitha vetë. Ka pasur shumë raste që ai i ka nxjerrë fëmijët vetë në kushte shumë të vështira që sot as nuk mendohen. Mjeku i asaj kohe do thosha që ishte mik shtëpie, ai vizitonte të sëmurin dhe mbetej mik shtëpie, Pra, duke qenë mik shtëpie, mbetej edhe mjeku më i mirë i shtëpisë. Dhe kujtoj që thoshte gjithmonë, që kur do bëheshin martesat, pra familja që kishte djalin për t'u martuar me dikë, i thoshin gjyshit: "Doktor, ju keni vizituar edhe familjen e filanit, a mundemi ne që të marrim nuse për djalin, vajzën e asaj familje, sepse duhet ta dimë a ka ndonjë problem shëndetësor?

Shumë interesante kjo doktor....?!

Pa dyshim shumë interesante dhe shumë e fortë, pra që në atë kohë njerëzit interesoheshin për shëndetin dhe kjo tregon kulturë. Pasi njerëzit do lindnin fëmijë dhe duhet ta dinin se ku shkonin.

Po sot kjo gjë mungon doktor...?

Absolutisht mungon dhe mungon krejtësisht kjo, edhe pse janë të gjitha mundësitë për t'u bërë. Dhe gjyshi, për të mos fyer një familje që mund të kishte një sëmundje psiqike të lindur ➔

etj., i thoshte: "Shikoni, mundohuni të gjeni në një vend tjetër. Nuk ka nevojë që të mbeteni vetëm aty, shikoni ka edhe të tjerë". Pasi hapur nuk mund të dilte, se ishte sekret profesional, por edhe pa ia thënë nuk mund të rrinte, se ata e pyesnin dhe kishin besim në fjalën e tij. Pra, desha të them, se mjeku i shtëpisë, ishte dhe mik shtëpie dhe ishte gjithçka për ta. Dhe tjetra, se misioni i tij ishte i tillë, pra jemi në Vlorën e vitit 1925-1930 dhe kështu me radhë. Pra, nuk kishte mjek nate. Kuptohet se shumica e fshatrave në Vlorë nuk kishte mjek. Ç'ndodhte? Në ora dy të natës binte dera e gjyshit tim, vinte p.sh. një nga Tragjasi dhe i thoshte fjala vjen, doktor unë kam gruan shumë sëmurë, keq, apo duke lindur etj. Të lutem shumë duhet të vish, si do bëjmë? Dhe i shkreti në dy të natës, i hipte kalit, se vetëm me kuaj bëhej kjo punë, vishte një mushama të madhe se binte shi dhe shkonin në Tragjas. Rrinte aty gjithë natën sa mund të rrinte dhe në mëngjes kthehej në shtëpi. Por kjo nuk ndodhte rrallë, kjo gjë ndodhte shumë shpesh. Gjyshi si mjek ka mbuluar jo vetëm Vlorën, por të gjithë fshatrat e Vlorës. Ai kur shikonte familje të varfra, nuk i merrte kurrë para, ishte një njeri tepër human. Saqë kur ndërroi jetë në vitin 1957, kanë ardhur të gjitha këto familje ku ai kishte shkuar ndër vite si mjek për t'i vizituar, e kanë marrë arkivolin e tij në krah duke bërë rreth 5 km nga Vlora në Nartë, se gjyshi është varrosur në Nartë. Një gjë e jashtëzakonshme, unë kam qenë i vogël atëherë, por nuk e harroj kurrë atë varrim madhështor, apo më saktë, varrim i ndjerë, jo varrim thjesht për t'u dukur, pra kishin ardhur të gjithë njerëzit atje që u ishte gjendur për 57 vjet. Dhe e dyta që kishin shumë respekt njerëzit për gjyshin, ishte fakti se ai kur i shikonte kështu të varfër, nuk u merrte para.

Njeri human...

Absolutisht tepër human. Dhe vazhdoi ta ushtroj këtë profesion deri kur ishte 84-85 vjeç, se ai vdiq 86 vjeç. Dhe në atë kohë unë isha i vogël rreth 10 vjeç dhe, në fakt, ai që më shtyu të bëhesha mjek, ishte gjyshi im. Le të themi që ai më futi në profesion që i vogël, sepse më merrte aty kur vizitonte njerëzit dhe ndonjëherë më jepte dhe stetoskopin në vesh e më thoshte, dëgjoje...?! Unë atëherë isha në klasë të tretë të katërt, siguristh shkruaja dhe mbaja shënime duke shkruar në një bllok emrat e të sëmurëve dhe unë në një farë mënyre u dashurova me atë profesion...

Pra, ju futi në profesion...?

Po, po më futi në atë profesion

Por babai juaj nuk e mori profesionin e tij...?

Në fakt, jo, e dini pse?! Gjyshi im kishte 3 djem, babai im Telemaku u bë jurist, një vëlla tjetër i tij u bë farmacist, dhe tjetri përsëri jurist. Në fakt, ai kishte lënë një si amanet: "Unë nuk dua t'ju bëj mjek"?! Sepse ai mendonte se do vazhdonte kjo historia e ngritjes

natën dhe e shqetësimeve madhore ditën. Pra, tha; "Më mirë merrni një profesion tjetër, që siç kam vuajtur unë, të mos vuani ju". Dhe ajo që më mrekulloi, ky njeri që punoi për 57 vjet, kishte vetëm një shtëpi dykatëshe në Vlorë, që e kishte bërë vetë dhe pjesën tjetër të parave ai i përdori për të studiuar djemtë.

Pra, investimi i tij kryesor ishin studimet e djemve...?

Absolutisht po, por djemtë i futi për të studiuar që në moshën 10-11 vjeçare dhe i çoi të tre jashtë deri sa u diplomuan. Pra, me një largpamësi të jashtëzakonshme, të gjithë të ardhurat e kursimet që kishte në fakt, ai i përdori të gjitha për të edukuar e arsimuar djemtë e tij. Për mendimin tim liceu të forcon dhe edukon. Habitem që gjyshi im që në atë kohë, pra 100 vjet përpara e kishte idenë që djemtë duhej të studionin jashtë. Thashë pak më lart se gjyshi i çoi tre djemtë e tij në moshën 11 vjeçare jashtë, pasi deri në moshën 11 vjeç i mbajti këtu që të mësonin mirë gjuhën shqipe të cilën ata nuk mund ta harronin më dhe pastaj i çoj jashtë për studime.

Po babai juaj ku ka studiuar?

Babai im Telemaku ka studiuar në Bari të Italisë që në moshën 11 vjeçare. Në Bari në atë kohë ishte një mikeshë e gjyshit tim, e vendosur atje me të shoqin dhe babai u sistemua në konvikt, ndërsa kjo zonjë, e merrte të shtunave dhe të dielave në shtëpi, për t'i dhënë një drek një darkë e kujdesej për të në konvikt. Bëhet fjalë për vitet 1922-'24-'25, pra pas ardhjes së Musolinit në fuqi, por shkollat në atë kohë me thënë të drejtën kanë qenë shumë të forta në Itali. Babai pasi mbaroi 8-vjeçaren si të thuash, pastaj shkoi dhe bëri Liceun në Firence. Firencja ishte një kryevepër, ishte vendi i Kulturës, i Rilindjes italiane, ishte kryeqyteti i Kulturës jo vetëm italiane, por dhe botërore me artistët e famshëm. Ç'është e vërteta, ai më thoshte se; "Kam përfituar shumë", pasi me shokët e tij që i kishin prindërit intelektualë, organizonin çdo të shtunë me miqtë e tyre nga një takim, një darkë. Dhe këta njerëz, nga shtatë tetë vetë, mblidheshin, i ftonte i zoti i shtëpisë që djalin e kishte shok klase me babanë, i cili i thoshte: "Hajde dhe ti të dëgjosh, të bisedosh se çfarë bëhet, çfarë thuhet". Dhe unë shkoja thoshte babai, zija një karrige aty në qoshe së bashku me shokun tim dhe vetëm dëgjoja. Ajo ka qenë një universitet tjetër për mua thoshte babai. Se aty flitej për Mikelanxhelon aty flitej për Rafaelon, për Bethovenin...etj etj.

Ka marrë një formim kulturor....?

Po, të jashtëzakonshëm. Gjithmonë kur e kujtoj, ai më thoshte: "Unë e kam fituar kështu këtë punë". Pastaj pati mundësi të shikonte muzetë, muzeu i Firences që ishte vërtet shumë i rrallë. Pastaj mbaroi Liceun e Firences që ishte shumë i fortë, pasi kur shkonin këta për të dhënë provimet, iknin të gjithë pedagogët dhe vinin të tjerë të panjohur për t'i marrë në provim. Pedagogët që vinin, shikonin ecurinë e mësimeve gjatë viteve dhe të pyeste në provim pa e ditur fare se kush je, pasi emrat mbuloheshin. Dhe kështu nxënësi merrte atë që meritonte. Pra, edhe pse ishte një sistem fashist, shkollat ishin jashtëzakonisht të forta, këtë e thoshte shpesh babai.

Po pas Liceut...?

Pasi mbaroi Liceun, erdhi koha që do bëhej mjek dhe i thotë gjyshi im: "A do bëhesh mjek, a do bëhesh jurist"? Në fillim babai i tha: "Ta provoj njëherë", dhe shkoi në Bolonja për Mjekësi. Bëri nja tre muaj për Mjekësi dhe e pa se nuk po i pëlqente, pasi vëllai i gjyshit tim, kishte mbaruar në Paris dhe ishte avokat në Aleksandri. Ai i tha babait; "Ç'të duhet Mjekësia, bëhu avokat, do jesh më mirë". Dhe babai vajti në Lozanë të Zvicrës. Lozana atëherë kishte fakultetin e Drejtësisë më të mirë në Evropë. Ndërsa dekani i Fakultetit të Drejtësisë në atë kohë, ishte kështilltar i Mustafa Qemal Ataturkut dhe e kishte ndihmuar Ataturkun për të bërë Kushtetutën e Turqisë. D.m.th. ishte një celebritet. Babai e thoshte bukur, ky njeri që kishte ndenjur tre vjet me Qemal Ataturkun në Ankara, thoshte: "Njeri më inteligjent se Qemal Ataturku nuk kam parë, ishte i jashtëzakonshëm. Ndriçohesh (kthjellohesh) kur pinte konjak, ishte një njeri i çuditshëm, kur e shihje kështu në pamje të parë nuk të krijonte ndonjë ndjesi, por kur pinte konjak, 'i ndizeshin llambat' dhe bëhej zheni...."?!

Kushedi se çfarë ndikimi kishte konjaku....?

Si duket po, se ai, në fakt, nga ceroza vdiq, dhe nga hallet e mëdha që kishte, se ai e krijoi Turqinë e re. Ai ishte njeri shumë i madh, i thoshte dekani, këtë babai e kujtonte shpesh. Dhe kur mbaroi në Lozanë fakultetin në vitin 1934, më thoshte se aty kishte shumë të huaj, shqiptarë, bullgarë, pra ballkanas dhe një pjesë e tyre ishin fëmijë bejlerësh të pasur dhe vinin e ia shtronin me poker, me të pira, me femra etj. etj. dhe nuk mbaronin kurrë shkollën. Disa thoshte babai, i gjeta aty dhe i lashë aty, ndërsa unë mësoja shumë, se i ati, pra gjyshi im, i thoshte: "Unë po sakrifikoj shumë që të kam çuar ty aty në atë shkollë. Të kam dërguar dhe paratë dhe unë dua diplomën, të lutem, ndryshe ta mbyllim këtë punë". Dhe unë thoshte babai, këtë përgjegjësi e kisha maksimale. Po kur mbaroi fakultetin, babai thoshte se nuk harroj dy mesazhe që na ka dhënë dekani i fakultetit të Lozanës ne studentëve. "Nuk u bë ceremoni me bujë e rrëmujë siç bëhet këtu duke hedhur kapelat etj., poshtë e lart. Aty kishte seriozitet maksimal. Erdhi dekani dhe na tha: Unë do u jap vetëm dy porosi, se ju do të bëheni gjyqtarë. E para: kur t'ju pyesin për ndonjë gjë, ju kurrë nuk do jepni përgjigje në këmbë. Se po e dhatë në këmbë, do gaboni. Uluni, dëgjojeni pyetjen, koncentrojeni dhe pastaj jepni mendim. Kurrë mos jepni mendim në këmbë". (Këtë gjë babai ma dha porosi dhe mua, që kurrë nuk do japësh përgjigje në këmbë për një pacient, se duke nxituar gabon. Ulu dhe jep përgjigje). Dhe e dyta që është më e bukura, dekani jua tha se "Ju do bëheni gjyqtarë dhe do jepni vendimin për të pandehurin. Për një moment, mbyllni sytë dhe ndërroni rolet, thoni sikur të isha unë në vendin e të pandehurit, çfarë dënimi meritoja? Shtatë vjet apo dhjetë vjet, atë do t'i jepni".

Porosi të vyera...?!

Të jashtëzakonshme...profesor që të mësojë kështu...?! Shiko, babai im ka qenë dhe gjyqtar që para lufte, por kjo gjë ishte e artë, dhe këtë porosi ma ka lënë dhe mua. Ai më thoshte: "Dëgjo djalë, kur do shkosh para të sëmurit, ki parasysh, ndërroni rolet, shko në vend të sëmurit, vish pizhamet dhe futu në krevat dhe rri aty, ndërsa ai i sëmuri të jetë në vendin tënd. Si do ta shikosh ti këtë të sëmurë? A do të vij mirë ty që ai të merret me ty në mënyrë të përciptë, të mos të të shohë të mos të dëgjojë?! Atëherë ti do kesh bërë dëmin më të madh, gabimin më të madh, prandaj mundohu gjithmonë të ndërrosh vendet që të bësh misionin si duhet".

Kështilla mjaft të vyera....

Mjaft të vyera, kështu që ai nuk i harronte kurrë porositë e dekanit. Dhe kur mbaroi fakultetin në Lozanë, ku kishte dalë shkëlqyeshëm, babai filloi punë në Byronë Internacionale Dytrevaj, d.m.th. Zyra Ndërkombëtare në Gjenevë, që ishte në Lidhjen e Kombeve. (Sot është OKB-ja). Aty punoi nja tre-katër vjet dhe atëherë ju e dini se ishte patriotizmi, pra duhesh të ktheheshe në vendin tënd dhe shqiptarët ktheheshin në atdhe t'i shërbenin vendit të tyre. Dhe, në fakt, ai dëgjoi babanë dhe u kthye.

Ku u vendos babai kur u kthye në Shqipëri?

Ai kur u kthye u vendos në Durrës ku punoi si gjyqtar dhe fakt është se aty gjeti një ambient intelektual të nivelit të vet, sepse ishin të gjithë të mësuar jashtë. Dhe u ambientua mirë dhe paguhej shumë mirë, kur të kishte ndonjë problem mund të dilte shpesh jashtë shtetit se nuk kishte vizë, paraja që ishte në atë kohë napoloni, ndërrohej në çdo vend të botës se nuk kishte problem dhe kështu që i kishte të gjitha mundësitë e jetoi aty ku u martua dhe me nënën time.

(Intervistoi,
Albana Shehu Qirjako)
(vijon nesër)

Daçiç: Një tjetër shtet ka tërhequr njohjen e Kosovës

Deklarata e ministrit serb, MPJ kosovare: Logjika e Millosheviçit, përhapin lajmin e rremë

Unioni i Komoreve ka tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës, ka thënë Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç. Ai u shpreh në një konferencë shtypi me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar të Unionit të Komoreve, Suef Mohamed El-Amin, se ky shtet është vendi i dhjetë që tërhoqi njohjen. Ministri i Jashtëm i Serbisë njoftoi më herët se ai pret që një vend tjetër të tërheqë njohjen e pavarësisë së Kosovës. Unioni i Komoreve është një republikë shtetërore, e vendosur në pjesën veriore të Kanalit të Mozambikut në bregun lindor të Afrikës ndërmjet Mozambikut verilindor dhe Madagaskarit veriperëndimor. Ndërkaq, pas deklaratës së ministrit të Jashtëm serb Ivica Daçiç vjen reagimi nga ministria e Jashtme kosovare. Përmes një deklarate publike MPJ kosovare thekson se po përcjellë me kujdes fushatën agresive dhe jo demokratike të Serbisë. "Në kuadër të kësaj fushate, me qëllim të bërjes së saj sa më të besueshme dhe me efikase, e njëjta, viteve të fundit nuk ka ngurruar të përfshihet edhe në marrëdhënie që cenojnë ligjin ndërkombëtar, sikurse është dhurimi i armëve regjimeve të cilat supozohet se do të mund t'i shfrytëzonin ato për projektim të dhunës në shtypje të pakënaqësive qytetare. Po ashtu, Serbia po keqpërdor edhe reputacionin e vendeve të cilat e kanë njohur Kosovën, duke përdorë logjikën e regjimit të Millosheviçit, me të cilën propaganda dhe mashtrimi synohej ta zëvendësonin realitetin. Në këtë frymë, edhe sot Serbia në bashkëpunim me mediat e instrumentalizuara përhapi lajmin e rremë, se gjoja Unioni i Komoreve paska tërhequr njohjen për Kosovën", thuhet në reagimin e MPJ-së. Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Jashtme siguron publikun se posedon informacion dhe korrespondencë nga burime të shumëfishta kredibile, nga aktorë globalë, informacion, i cili rikonfirmon atë që është pohuar gjithnjë, që vendet në të cilat thirret Serbia, e mohojnë të kenë marrë apo të konsiderojnë të marrin vendim për tërheqje të njohjes. "Më saktësisht të gjitha vendet në të cilat thirret Serbia, kanë konfirmuar që bëhet fjalë për lajme të rreme, dhe se njohjet e tyre konform praktikës së marrëdhënieve ndërkombëtare janë akte të pakthyeshme. Kundrejt kësaj Serbie jashtë kontrolli, rreziku me të cilën përballët Kosova është zhytja në debate jo produktive dhe pa rezultate. Serbia do të ndalet vetëm atëherë kur e kupton që përkundër debatit institucional ne vazhdojmë të veprojmë në unitet", -thuhet në reagimin e MPJ-së.

REAGIMI I MPJ KOSOVARE

"Serbia po keqpërdor edhe reputacionin e vendeve të cilat e kanë njohur Kosovën, duke përdorur logjikën e regjimit të Millosheviçit, me të cilën propaganda dhe mashtrimi synohej ta zëvendësonin realitetin. Në këtë frymë, edhe sot Serbia në bashkëpunim me mediat e instrumentalizuara përhapi lajmin e rremë, se gjoja Unioni i Komoreve paska tërhequr njohjen për Kosovën", thuhet në reagimin e MPJ-së.

Veseli: Mosliberalizimi i vizave, racizëm i skajshëm nga BE

Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit të Kosovës, tha të ditën e djeshme se të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave janë përmbushur dhe se në rast se Bashkimi Evropian nuk i liberalizon vizat për kosovarët, atëherë kjo do të ishte "racizëm i skajshëm". Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Veseli tha se nuk do të ndalet së lobuari për liberalizimin e vizave dhe se në të njëjtën kohë do të jetë edhe më i zëshëm në të drejtën e qytetarëve të Kosovës për të lëvizur pa viza në Evropë. "Shikoni krahasimin me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova qëndron shumë më mirë qoftë në aspektin e respektimit të shtetit ligjor apo në atë ekonomik. Nuk duhet të lejohet askush të na privojë nga e drejta që na takon. Qëndrim i imi politik është ky: ky është racizëm, racizëm i skajshëm", tha Veseli. Këshilli i Bashkimit Evropian pritet që në dhjetor të vendosë për ose kundër liberalizimit të vizave për Kosovën. Disa shtete kanë shprehur skepticizëm nëse Kosovës duhet t'i ofrohej liberalizimi i vizave. Këtë e konfirmoi të martën gjatë vizitës në Prishtinë edhe kancelari austriak, Sebastian Kurz, vendi i të cilit mban kryesimin aktual të Bashkimit Evropian, shkruan rel. Ai tha se ende ekziston një skepticizëm te vendet anëtare lidhur me procesin e liberalizimit të vizave.

Normalizimi i marrëdhënieve, Mogherini: Pritet konfirmimi i dy liderëve

Dialogu Kosovë-Serbi, Thaçi dhe Vuçiç takohen sot në Bruksel

Votimi i rezolutës për dialogun, Kuvendi në seancë

Federica Mogherini, shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, do të presë sot në Bruksel presidentët e Kosovës dhe të Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiç. "Në takim, dy liderët pritet të konfirmojnë gatishmërinë e tyre për të intensifikuar punën drejt arritjes së një marrëveshjeje ligjërisht të detyrueshme për normalizimin gjithëpërfshirës, i cili është vendimtar për rrugët e tyre evropiane",-thuhet në komunikatën e lëshuar nga zyra e Mogherinit. Takimi pritet me interes nga palët, pas debateve që shkaktoi ideja e presidentit Thaçi për korrigjim të kufijve mes dy vendeve. Ndërkaq në shtator, një takim i thirrur nga Mogherini midis Thaçit dhe Vuçiçit ka dështuar, me tërheqjen e këtij të fundit. Paraprakisht, Thaçi dhe Vuçiç janë takuar në Alpbah të Austrisë, ku kanë shpalosur publikisht idenë për ndryshimin e kufijve, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis dy vendeve. Nga ana tjetër, në Kosovë është duke u shqyrtuar sërish në Kuvend rezoluta për dialogun me Serbinë, e cila ka shkaktuar polemika mes grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës, të cilët dështuan në gjetjen e kompromisit në seancën e 1 nëntorit. Kuvendi i Kosovës vijoi sërish dje seancën plenare nga ku u parashikuan të diskutoheshin një sërë pikash. Pika e parë e seancës është votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të Kosovës Hashim Thaçi për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Kujtojmë nga ana tjetër se ditën e martë, ka vizituar Kosovën kancelari austriak Sebastian Kurz. Ai tha të hënën se Serbia nuk do të mund të hyjë në Bashkim Evropian pa gjetur një zgjidhje me Kosovën dhe kjo sipas tij është kushti kryesor drejt kësaj rruge. Ai i bëri këto komente në një konferencë për gazetarë në Beograd pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Kancelari Kurz tha se është me rëndësi që bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës jo vetëm të vazhdojnë, por edhe të përfundojnë me sukses. "Ne kemi një mundësi unike tani që ta lëmë historinë në histori dhe të lëvizim përpara në një të ardhme të suksesshme. Njerëzit në Serbi duhet të kuptojnë se Serbia mund të hyjë në Bashkimin Evropian vetëm nëse Beogradi dhe Prishtina gjejnë një zgjidhje. Ky është kushti kryesor për Serbinë për t'u bashkuar me Bashkimin Europian," tha Kurz. Ndërsa, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç tha se çdo zgjidhje për Kosovën duhet të jetë e mirë për të dyja palët si për serbët ashtu edhe për shqiptarët. "Ajo që është e rëndësishme për ne është se Serbia nuk mund dhe nuk duhet të jetë e poshtëruar dhe kjo është njëra anë, pala shqiptare nuk mund të marrë gjithçka dhe pala serbe asgjë. Ata që janë të përgatitur që ta marrin këtë parasysh dhe të cilët janë të gatshëm të kërkojnë për një zgjidhje të tillë, do të kenë gjithmonë një partner këtu në Beograd", tha presidenti Vuçiç duke nënvizuar se të dyja palët edhe Serbia edhe Kosova janë shumë larg arritjes së një marrëveshjeje. Presidenti Vuçiç ndërkaq kritikoi vendet që janë shprehur kundër çdo marrëveshjeje që prek ndryshimet e kufijve dhe që drejtojnë se prekja e kufijve, mund të nxisë lëvizje të ngjashme edhe në pjesët tjera të rajonit, që ende nuk është rimëkëmbur nga luftërat e përgjakshme të fundit të shekullit të kaluar. "Ne jemi me milje larg nga çdo zgjidhje. Kjo zgjidhje duhet të gjendet mes serbëve dhe shqiptarëve dhe unë do të doja t'i pyesja të gjithë ata të cilët po thonë se ne mund të hapim një lloj kutie të Pandorës tani - përse e keni njohur pavarësinë e Kosovës dhe keni hapur 'kutinë e Pandorës' në vitin 2008?", tha Vuçiç. Kosova dhe Serbia janë përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve që është kusht për integrimet në Bashkimin Evropian, i cili edhe ndërmjetëson bisedimet. Por, ndonëse ishte thënë se vjeshta mund të shënojë një periudhë takimesh të ngjeshura ndërmjet të dyja palëve, takimi i fillimit të shtatorit dështoi dhe tani për tani nuk ka asnjë lëvizje nga Brukseli. Të dy presidentët pohojnë se janë larg ndonjë marrëveshjeje dhe nuk kanë pranuar të thonë nëse tashmë kanë hedhur në letër idetë që një pjesë e veriut të Kosovës, të shkëmbehet me një pjesë të luginës së Preshevës.

Hashim Thaçi, Federica Mogherini, Aleksandar Vuçiç

KOMUNIKATA E MOGHERINIT

"Në takim, dy liderët pritet të konfirmojnë gatishmërinë e tyre për të intensifikuar punën drejt arritjes së një marrëveshjeje ligjërisht të detyrueshme për normalizimin gjithëpërfshirës, i cili është vendimtar për rrugët e tyre evropiane", thuhet në komunikatën e lëshuar nga zyra e Mogherinit.

Heqja e imunitetit të Gruevskit, "dritë jeshile" nga komisionet

Komisioni për çështjet e mandateve dhe imunitetit në parlamentin maqedonas i hapi rrugë heqjes së imunitetit të Nikolla Gruevskit. Kërkesa iu drejtua parlamentit nga Gjykata Penale që e ka dënuar ish-kryeministrin me 2 vite burg për abuzim me tenderët për automjetin e tij luksoz. 5 nga 9 anëtarët e komisionit votuan pro dhe 1 kundër. Dritën e gjelbër ia dha të martën edhe komisioni për çështjet kushtetuese. Votimi do të bëhet në seancën e të premtes, por gjasat janë të pakta që Gruevskit t'i hiqet imuniteti. Talat Xhaferi, Kryetar i parlamentit të Maqedonisë: Shumica parlamentare nuk i ka 2/3 e votave. Por unë si kryetar parlamenti kam detyrimin ta nxjerr në rend dite në bazë të procedurave, në bazë të afateve që i parashtrojmë. Shumica qeverisëse siguroi 80 vota pasi 10 deputetë të VMRO-DPMNE-së pranuan të bashkëpunojnë për ndryshimet kushtetuese sipas marrëveshjes me Athinën. Por ata nuk do të mbështesin heqjen e imunitetit të Gruevskit.

"Përplasja e dy Amerikave", nën hetim administrata e Trump

SHBA, demokratët shpallin fitoren në Dhomën e Përfaqësuesve

Zgjedhjet, 112 femra në Kongresin Amerikan

Kanë shpallur fitoren ditën e djeshme në SHBA Demokratët për Dhomën e Përfaqësuesve në zgjedhjet e së martës, ndërsa republikanët duket se kanë mbajtur kontrollin e Senatit. Megjithëse demokratët fituan në disa gara kyçe të martën, ata nuk realizuan atë që po quhej "valë blu" fitoresh në zgjedhjet e Kongresit dhe që analistët kishin thënë se do të kishte qenë një kundërshtim ndaj presidencës së presidentit Donald Trump. Mbajtja e kontrollit të Senatit nga republikanët u duk thuajse e padiskutueshme kur demokratët humbën gara kyçe në Indiana dhe Tenesi, dy shtete që Presidenti Trump i fitoi lehtësisht në vitin 2016. Marrja e kontrollit të Dhomës së Përfaqësuesve nga demokratët, do të thotë që ata do të jenë në gjendje të frenojnë axhendën e Presidentit republikan, Donald Trump. Fitorja do të thotë, gjithashtu, që Dhoma e Përfaqësuesve do të jetë në gjendje të ndërmarrë hetime ndaj administratës së Presidentit Trump. Ndërkaq, në mesin e mandatit të tij Donald Trump ndodhet përpara testit të parë. Zgjedhjet e Kongresit këtë vit kanë marrë formën e një referendumi të vërtetë për presidentin amerikan. Politikat e tij kanë përçarë analistë vendas e të huaj, por edhe vetë popullin. Dy Amerika do të përplasen kokë më kokë, shkruan CNN në analizën e zgjedhjeve, duke shpjeguar se si Trump e ka ndarë opinionin më dysh. Humbja e shumicës nga republikanët rrezikon politikat emblemë të Donald Trampit si ashpërsimi i ligjeve për migracionin, marrëveshjet e reja tregtare ndërkombëtare apo reduktimi i taksave. Me një Kongres kundër, problemet mund t'i thellohen presidentit edhe në hetimet për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet e 2016, konfliktin e interesit apo aferat seksuale. Sipas rrjetit televiziv, Presidenti kishte mbështetjen e elektoratit rural dhe të të pashkolluarve, por, nga ana tjetër, të rinjtë, afroamerikanët grupet minoritare dhe veçanërisht gratë kundërshtojnë linjën e tij. Amerikanët votuan për rinovimin e shumicës së anëtarëve të Kongresit dhe pjesën më të madhe të guvernatorëve. Zgjedhjet e mesit të mandatit janë prova e parë për Donald Trumpin që kur mori presidencën 2 vite më parë. Republikanët synuan të ruajnë dominimin në senat dhe dhomën e përfaqësuesve për të çuar përpara reformat e presidentit Trump. Ndërsa demokratët, procesi është tregues për presidencialet e 2020-ës. Ditët e fundit të fushatës, presidenti Trump shprehu bindjen për fitoren, por akuzoi demokratët për përpjekje për manipulimin e zgjedhjeve. "Demokratët po inkurajojnë hapur miliona emigrantë të jashtëligjshëm të hyjnë në vendin tonë për t'u marrë votën". Por për ish-zv/ presidenin Xho Bajden, amerikanët e kanë të qartë se për kë duhet të votojnë. "Ne zgjedhim bashkimin mbi përçarjen, shpresën ndaj frikës, aleatët para armiqve, të vërtetën ndaj gënjeshtrës". Humbja e shumicës nga republikanët rrezikon reformat emblemë të Donald Trumpit si ashpërsimi i ligjeve për migracionin, marrëveshjet e reja tregtare ndërkombëtare dhe reduktimi i taksave. Problemet mund t'i thellohen presidentit edhe në hetimet për ndërhyrjen ruse në zgjedhje, konfliktin e interesit apo aferat seksuale. Zgjedhjet amerikane të mesmandatit patën mjaft zhvillime interesante, siç është numri i më i madh historik i femrave që do të marrin pjesë në kongres. Kongres i risive mund të konsiderohet ai i legjislaturës së re të dalë nga zgjedhjet e 6 Nëntorit. Numri i grave kongresiste thyen rekord historik. 112 femra do të përfaqësojnë elektoratin në të dyja Dhomat e Kongresit, 5 më shumë nga legjislatura e kaluar. Pjesa më e madhe e tyre janë nga radhët e demokratëve. Demokratët sjellin edhe risi të tjera në këtë legjislaturë. Ata kanë sjellë në Kongres për të parën herë dy gra myslimane, Rashida Tlaib e Ilhan Omar. Në grupin e tyre janë edhe dy kongresistet më të reja në moshë në histori, Aleksandria Okasio - Kortez 29 vjeç dhe Abi Finkenauer 30 vjeç. Dib Haland dhe Saris Dejvids janë dy indianet e para amerikane që përfaqësohen në Kongres. Dejvids është e para pjesëtare e komunitetit LGBT në dhomën e përfaqësuesve ashtu si edhe homoseksuali i parë Xherd Polis.

Zgjedhjet per kongresin ne SHBA

112

FEMRA NE KONGRES

Do të përfaqësojnë elektoratin në të dyja Dhomat e Kongresit, 5 më shumë nga legjislatura e kaluar. Pjesa më e madhe e tyre janë nga radhët e demokratëve. Demokratët sjellin edhe risi të tjera në këtë legjislaturë. Ata kanë sjellë në Kongres për të parën herë dy gra myslimane, Rashida Tlaib e Ilhan Omar. Në grupin e tyre janë edhe dy kongresistet më të reja në moshë në histori, Aleksandria Okasio - Kortez 29 vjeç dhe Abi Finkenauer 30 vjeç.

Kamerun, lirohen 79 nxënësit e rrëmbyer nga ushtarët

Rasti i dytë që merren peng nga e njëjta shkollë, tre persona janë ende në robëri që nga e diela

Janë liruar nxënësit e rrëmbyer nga një shkollë në rajonin veriperëndimor të Kamerunit", thonë zyrtarët. 79 nxënës dhe tre persona të tjerë u rrëmbyen të dielën në kryeqytetin e rajonit, Bamenda. Drejtori i shkollës, shoferi dhe një mësues janë ende në robëri, raporton BBC. Rrethanat e lirimit të nxënësve nuk janë të qarta, por autoritetet thonë se po merren në pyetje para se të ribashkohen me prindërit e tyre. Sipas Kishës Presbyteriane të Kamerunit, studentët u braktisën në një nga ndërtesat e tyre në qytetin Bafut, rreth 24 km nga Bamenda. Kisha, gjithashtu, zbuloi se rrëmbimi i së dielës ishte rasti i dytë në të njëjtën shkollë në më pak se një javë. Ministri i Komunikimit Issa Bakary Tchiroma tha për AFP se "të gjithë 79 nxënësit janë liruar", por nuk dha detaje të mëtejshme. Rajoni ku u regjistrua ngjarja është anglofon dhe është i njohur për aktet e dhunës, pasi aty operojnë grupe rebele separatiste. Në të njëjtin rajon, në Tetor u vra një misionar amerikan.

79

NXENES

"79 nxënës dhe tre persona të tjerë u rrëmbyen të dielën në kryeqytetin e rajonit, Bamenda. Drejtori i shkollës, shoferi dhe një mësues janë ende në robëri", raporton 'BBC'.

SHKURT

Spanjë/ Alarm për bombë, evakuohen dy trena në Barcelonë

Policia në Barcelonë ka evakuar dy trena në stacionin kryesor të qytetit dhe po kryejnë kontrolle për eksploziv pasi u gjet një valixhe e dyshimtë. Forcat xheniere shkuan mëngjesin e së mërkurës me shpejtësi të lartë në stacionin qendror Sants. Policia raporton se administrata e sigurisë në stacionin hekurudhor identifikoi një objekt si një mjet shpërthyes të mundshëm brenda një valixheje në orën 8 të mëngjesit. Stacioni i trenit Madridit Atocha, gjithashtu, u evakua në mëngjesin e 7 nëntorit për shkak të alarmit të sigurisë. Një skaner i sigurisë në Barcelonë Sants zbuloi një objekt brenda një valixhe që mund të ishte eksploziv. Qarkullimi i trenave me shpejtësi të lartë është ndalur dhe udhëtarët nuk kanë arritur të hyjnë në stacionin hekurudhor.

UNESCO krijon "Observatorin e gazetarëve të vrarë"

Një observator i gazetarëve të vrarë, që synon të dokumentojë masat e marra për të ndëshkuar krimet e zhvilluara kundër gazetarëve profesionistë të medieve, u krijua nga UNESCO me qëllim luftimin kundër pandëshkueshmërisë së autorëve të këtyre vrasjeve, njoftoi sot kjo agjenci e OKB-së. "Ky Observator është një bazë të dhënash në internet mbi nivelin e përparimit të hetimeve gjyqësore të zhvilluara për çdo vrasje të gazetarëve apo të profesionistëve të medieve të identifikuar nga UNESCO që prej 1993, bazuar në informacionet e dhëna nga vendi ku ka ndodhur vrasja", shpjegon UNESCO në një komunikatë. Rreth 1 293 vrasje që prej vitit 1993 janë identifikuar nga ky Observator, nga të cilat 80 përkojnë me këtë vit.

OKB: Mbi 2 000 emigrantë të vdekur në Mesdhe

Më shumë se 2 000 emigrantë dhe refugjatë kanë vdekur që prej janarit në gjithë Mesdheun për të arritur Europën, njoftoi të martën OKB-ja, duke theksuar se më shumë se gjysma e tyre kanë vdekur ndërkohë përpiqeshin që të shkonin në Itali. "Rreth 105 000 azilkërkues dhe emigrantë kanë arritur Europën deri tani, për këtë vit, dhe numri i jetëve të humbura në Mesdhe kalon 2 000 persona", deklaroi një zëdhënës i Komisariatit të Lartë për Refugjatët (HCR) në OKB, Charlie Yaxley, gjatë një konference për shtyp në Gjenevë. Megjithatë këto shifra janë në rënia nëse krahasohen me ato të viteve të fundit..

PERKTHYESJA

CHEN FENGHUA: Çfarë mësova nga Kadare

Nga Chen Fenghua*

Përkthimi i letërsisë shqipe në gjuhën kineze dhe anasjell tas ka filluar nga vitet '50-'60 të shekullit të kaluar, por me kalimin e kohës, shumica e këtyre përkthimeve të para, qoftë për shkak të tematikës politike, qoftë për shkak të një tirazhi të kufizuar, mbeti në Kinë në harresë ose u zbeh, me përjashtim të disa fragmenteve të veprave të Dritëro Agollit dhe Ismail Kadaresë. Ndoshta edhe veprat kineze të asaj kohe po pësojnë të njëjtin fat në Shqipëri. Përkthimi i letërsisë midis dy gjuhëve filloi shumë vonë, pas viteve '90. Vetëm këto 10 vitet e fundit, me përkthimet letrare janë shtuar në një masë të konsiderueshme, sidomos për veprat e Ismail Kadaresë, duke nisur me romanin "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur" e me "Prilli i thyer", "Kronikë në gur", "Kush e solli Dorutinën", "Darka e gabuar", "Ura me tri harqe" etj. Më 2015, me ndihmën e Ambasadës së Kinës në Shqipëri, u nënshkrua Marrëveshja Kinë-Shqipëri për përkthimin dhe botimin e ndërsjellë të veprave klasike, për të thelluar shkëmbimet kulturore dhe miqësinë tradicionale midis dy vendeve. Ajo cakton që të dyja palët të botojnë nga 25 vepra brenda 5 vjetëve. Në Kinë, universiteti ynë BFSU-ja (Beijing Foreign Studies University) dhe shtëpia botuese FLTRP-ja (Foreign Language Teaching and Research Press), me përparësi në studimet albanologjike, u ngarkuan me këtë projekt, kanë krijuar komisionin e ekspertëve kinezë dhe shqiptarë dhe kanë propozuar listën e librave që do të përkthehen. Në Shqipëri, me Shoqatën e Botuesve të Shqipërisë dhe ndihmën e Shoqatës Kulturore Shqipëri-Kinë, janë përfshirë disa botues cilësorë, si Onufri, Dituria, OMBRA, etj., si dhe një grup përkthyesish veteranë, si Iljaz Spahiu, Kujtim Ymeri etj. Iljaz Spahiu më 2017 dhe Bujar Hudhri më 2018 morën çmimin specifik kinez të librave në Pekin. Ky projekt qeveritar është shumë domethënës për ne si Katedër e Gjuhës Shqipe dhe si Qendër e Studimeve Shqiptare. Shohim një mundësi të madhe perspektive për të kualifikuar përkthyes të rinj dhe për të thelluar studimet albanologjike në Kinë. Dhe besojmë se me këto vepra të përzgjedhura nga fusha të ndryshme, edhe më shumë kinezë do të dinë për Shqipërinë dhe shqiptarët dje, sot dhe nesër.

TË JEM LEXUES

Shkrimtari italian Italo Calvino ka thënë "Ai që zotëron historinë nuk është zëri, por veshët". Para se ta përktheja "Aksidentin", kisha lexuar disa romane të Kadaresë, si "Gjenerali", "Ura me tri harqe" dhe "Kështjella". Por këto romane i kam lexuar për qejf, që do të thotë se kur hasja në fjalë dhe fjali që nuk i kuptoja, i anashkaloja pa mundimin për të gjetur kuptimet e sakta. Me siguri, njëra arsye vjen nga dëmbelizmi i lexuesit, tjetra është që procesi i hamendjes vetë bën një punë fantastike. Kështu, leximi i një vepre letrare mbetet një pushim i këndshëm, kurse përkthimi i saj është krejt ndryshe, një punë e lodhshme. Së pari, duhet të isha në çdo moment një lexues i kujdesshëm. Në çdo pikë, në çdo qoshe më duhej të ndalesha për të biseduar me autorin, për t'i bërë pyetje, çfarë qëndronte nëpër germat, paragrafët..., derisa të kapja diçka që të më bindte. Duket se "Aksidenti" luajti rolin e një trajneri me përvojë. Ai më shfaqet, në pjesën e parë, si një roman policor (hetimi për aksidentin), duke më zgjuar që në fillim kureshtjen për të gjetur rezultatin; në pjesën e dytë, romani shndërrohet në një histori dashurie; shënimet, ëndrrat, rrëfimet dhe situata reale, gërshetohen në historitë e personazheve kryesore, dashuria jeton në rrëmujë derisa të lind dyshimi; kurse në pjesën e fundit, historia përfundon në paqartësi, e vërteta mbetet në hije, sepse ndoshta kjo e vërtetë nuk ka rëndësi. Duke e krahasuar me romanet e tjera të Kadaresë, subjekti në këtë roman paraqitet në një mënyrë më të copëtuar, më kryqëzuar nëpër personazhe të ndryshme, tamam si të jesh duke lexuar një dosje hetimi, ku aty-këtu dalin prova nga më të ndryshmet, të cilat duhet t'i përmbledhësh me kujdes dhe durim, që të mos fluturojnë pa i vënë re.



Ismail Kadare

Përkthyesja kineze e "Aksidentit", në një rrëfim për shkrimtarin

KUALIFIKIMI

Në këtë roman Kadareja thotë "Si çdo histori, asaj do t'i duhej të kalonte nëpër tri faza: përfytyrimi pa fjalë, pastaj veshja me to, së fundi rrëfimi për të tjerët". Pa dyshim, Kadareja shquhet në çdo fazë. Vështirësia bie tani mbi përkthyesit, kryesisht lidhur me pjesën e fundit të thënies se Kadaresë - rrëfimi për të tjerët, sidomos për ata që mbartin një kulturë tjetër. Duke marrë parasysh diferencat kulturore, kaq të mëdha midis dy gjuhëve, përkthyesi gjithmonë do të gjendet i gozhduar në një dilemë të vështirë: të ruajë sa më shumë shijet e tekstit origjinal, apo të bëjë ndryshime për t'ia përshtatur një teksti objektiv. Sidoqoftë, ka edhe "kapërcime ylberore", kur vetë "Aksidenti" e ndihmon përkthyesin që të kapërcejë natyrshëm pengesat kulturore, të cilat, do t'i quaja, përherë të bezdisshme. Në roman, autori e ka përdorur imazhin e "ylberit" në tri vende... ose duke fjetur me ylberin, ose duke e kapërcyer, dhe duke shpjeguar se "kapërcimi i ylberit" do të thotë ndryshimi i gjinisë. Por këto përdorime me ylber as nuk mund të përfytyrohen në kulturën kineze. Kur e hasa "ylberin" për herë të parë, m'u duk e pamundur t'ia shpjegoj kuptimin tekstor lexuesit pa shënime të hollësishme, por kur u përqendrova edhe dy-tri herë të tjera, shqetësimi im u zhduk. Kjo ndodhi sepse autori vetë e ka shpjeguar dukurinë në mënyra të ndryshme, gjithnjë më të qarta. Nga ky rast kuptova që përkthyesi duhet të ruajë gjakftohtësinë duke kërkuar nëpër rreshta shënime të ndryshme të autorit në origjinal dhe jo të vetëkrijojë me ngut e pa bazë. Në pamje të parë, kjo metodë ndoshta duket mosvepruese, por, nëse thellohesh, kuptohet se në shumë raste pikërisht më e thjeshta është më e mira.

KOMPLESITETI I DASHURISË

Pavarësisht se ju pëlqejnë ose jo personazhet e romanit apo ideja e autorit, nuk mund të mohojmë se me një strukturë të ndërlikuar dhe me gjuhë të përpiktë, ai paraqet kompleksitetin e dashurisë, jetës dhe botës që ne jetojmë. Nëpërmjet romanit autori vetë shtron pyetje për këto aspekte të jetës, dhe ai e di shumë mirë që nuk mund të gjenden përgjigje të qarta, por çdo njeri duhet të përgjigjet sipas jetës së vet. Autori shkruan diku në fund "... më pas do ta kuptoni se bota është më e ndërlikuar se ç'duket..." "... atëherë, sytë e verbër njerëzorë, befas, ashtu siç ndodh kur era ngre rastësisht cepin e perdes mbuluese [...] shihnin atë për të cilën do t'u duheshin shekuj". Në roman, autori ka të drejtë që lexuesit të jenë në dispozicion të tij, kurse në realitet, çdo njeri është i barabartë, është i kufizuar në kohë dhe në hapësirë. E bardha dhe e zeza që ndahen me një vijë të prerë nuk ekzistojnë, kompleksiteti është normal dhe i përhershëm dhe ne duhet ta kuptojmë dhe pranojmë që në fillim. Natyrisht, "Aksidenti" nuk është roman i thjeshtë për t'u përkthyer, sidomos për mua, që nuk kam shumë përvoja përkthimi. Gjatë përkthimit njëvjeçar, nga fillimi deri në fund, në çdo minutë ndihesha sikur ecja nëpër akull. Pikërisht nga këto pengesa të shumta, kam fituar fillimisht statusin e një lexuesi jo të thjeshtë dhe pastaj shkallë-shkallë të fshehtat e përkthimit që janë të panumërta. Me këtë rast, falënderoj prof. Ke Jing, prof. Emil Lafe, prof. Shaban Sinani, prof. Floresha Dado dhe prof. Ruzhdi Stringa, pa ndihmën e të cilëve, ky version kinez nuk mund të dilte me sukses. Librat kanë fuqinë e vet. Njeriu që lexon nuk bie asnjëherë në vulgaritet. Është mrekulli shumëfishe të përkthesh një libër që të pëlqen. Ndarja e librave të mirë me të tjerët është eksperiencë me vlera. Më bie ndërmend se para afro 50 vjetësh, dublimi i filmave shqiptarë në Kinë, u pati dhënë kinezëve të asaj kohe një dritare të vogël për të parë botën. Në kohën e sotme, me pjesëmarrjen në projektin e përkthimit dhe botimit, ne do të hapim më shumë dritare për njëri-tjetrin dhe me përpjekjet e çdo përkthyesi dhe botuesi, jetët tona do të bëhen më të afërta, kulturat më të kuptueshme dhe lidhja më e ngushtë.

**** Përkthyese. Universiteti i Gjuhëve të Huaja i Pekinit.***

RINGRITJA E KINEMAVE NË GJIROKASTËR DHE VLORË

Ka një projekt pilot të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për ringritjen e Kinemave në Gjirokastër dhe Vlorë, i cili vjen falë projektit CIRCE, mbështetur nga Programi IPA i Bashkimit Evropian dhe ka 4 partnerë Mesdhetarë. Në Shqipëri projekti drejtohet nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë që prej disa vitesh ka punuar në hartimin e këtij projekti, i cili ka si qëllim pajisjen me aparatura të reja digjitale projeksioni dhe sistemin audio, sallat ekzistuese në qytetet kryesore të vendit. Gjatë këtyre 3 viteve të fundit Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka mbështetur vazhdimisht festivalet e filmit në qytetin e Shkodrës, Pogradecit, Sarandës dhe Gjirokastrës me qellim për të krijuar sensibilizimin e duhur të pushtetit dhe audiencës lokale ndaj hapjes së kinemave që ekzistojnë aktualisht në këto qytete. Si fillim do të kemi dy kinema, një në Gjirokastër dhe një në Vlorë dhe më pas edhe në qytetet e tjera që do ti bashkohen kësaj nisme të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Pajisja me mjete të reja digjitale do të jetë hapi i parë ndërsa krijimi i një programi të pasur me filma shqiptarë do t'i japin mundësinë publikut të këtyre qyteteve të njihen me realizimet më të mira shqiptare të viteve të fundit. Qendra Kombëtare e Kinematografisë festoi vjet 20-vjetorin e saj të krijimit. Gjatë këtyre viteve QKK ka financuar rreth 300 filma të gjatë, të shkurtër, dokumentarë dhe të animuar. Vetëm gjate 4 viteve të fundit janë financuar mbi 100 filma, pra rreth 1/3 e filmave të krijuar që nga krijimi i këtij institucioni. Vitin e kaluar, 25 filma te rinj shqiptarë u prezantuan përpara publikut të kryeqytetit, por nuk kanë pasur mundësi të prezantohen përpara publikut të qyteteve të tjera të vendit për mungesën e teknikës minimale në sallat respektive. Pikërisht ndryshimit të kësaj situate i përgjigjet kjo iniciativë që ka ndërmarrë QKK, e cila ka gjetur asistencën e partnereve tanë të Apuglia Film Commission dhe njëkohësisht mbështetjen nga fondet europiane nëpërmjet projektit

BOTIMI

"Secili çmendet simbas mënyrës së vet" në tri gjuhë

Nga Frano Kulli

Stefan Çapaliku me dy vëlli met e botuara në harkun e një viti, ka ndarë me ne një periudhë njëzetvjeçare prej një kohe të çmendur, e cila kaloi si një sëmundje e gjatë dhe sfilitëse mbi trupin e një vendi të varfër e të pashpresë, siç qe Shqipëria komuniste. Çapaliku në të dy vëllimet e para të sagës së vet i ka trajtuar ngjarjet e përzgjedhura si lëndë artistike, të cilat më vonë kanë prodhuar dhe vazhdojnë të prodhojnë në mendjet e lexuesve karaktere njerëzore sa reale e absurd aq edhe ekspresioniste e sureale.

Vëllimi i parë i ka shtjelluar ngjarjet në qytetin e Shkodrës, aty ku autori ka kaluar fëmijërinë e vet, duke shënuar kështu kontributin e tretë të rëndësishëm mbi qytetin. Siç besoj të gjithë biem dakord, libri i parë i çmuar për Shkodrën është "Rrethimi i Shkodrës" i Marin Barletit botuar më 1504, i dyti është "Shkodra e rrethueme" e Dom Ndoc Nikajt në vitin 1913 dhe i treti... këto dy vëllime që kemi tani në dorë.

Gozhdët, që mbajnë të tërhequr litarin e ngjarjeve, në romanin e parë të Çapalikut, janë ngulur, njëra në vitin 1967, kur Shqipërinë e shpallin shtet ateist dhe tjetra në vitin 1985, kur vdes ai që e shpalli, Enver Hoxha. Brenda këtyre dy ngjarjeve të forta, që përcaktojnë edhe segmentin më të ashpër dhe fanatik të komunizmit shqiptar, nxjerr krye një ngjarje tjetër, në dukje e vogël, që është ardhja e televizorit në shtëpinë e vendosur në qendër të romanit.

Ardhja e kësaj kutie magjike, tamam në çastin kur Shqipëria po kthehej në një ishull të shkretë e të pashpresë, e ndan romanin në tri pjesë: Para, Gjatë dhe Mbas. Romani e nis turrin tregimtar ndërsa jashtë po shkatërroheshin institutet e religjionit dhe brenda po lindte një institute i ri besimi, që ishte televizori, media. Ai i vë fre kallëzimit në kohën e realizimit të ëndrrës së diktatorit, vdekjes së tij në shtrat. Veçanërisht gjatë viteve të shndërrimit të shtëpisë së rrëfimtarit në një kinema, kemi rastin të njihemi nga afër me karakteret, të cilat qyteti bujarisht ia ka dhuruar kujtesës së autorit.

Autobiografik, romani është një dëshmi letrare e trupit, shpirtit dhe mendjes së vendit, përgjatë një prej lëngatave të tij më të pashpresa. Personazhet që lëvizin nëpër ngjarje, por, që edhe i parathonë e i projektojnë ato, janë aso qytetarësh, arketipa të një qytetërimi bashkëkohës. Ndërsa romani i dytë i ciklit "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" i vendos ngjarjet jo vetëm në Shkodër, por veçanërisht në Tiranë, si dhe në Tropojë e Jug të Shqipërisë. Ato nisin në prill të vitit 1985 dhe mbarojnë në fund të vitit 1990. Ky libër është vazhdim i vëllimit të parë të ciklit romanesk "Secili çmendet simbas mënyrës se vet", por mund të lexohet veçmas dhe pavarësisht nga i pari. Romani i dytë ka 29 kapituj dhe, ashtu si i pari, është ndarë në tre pjesë: "Fundi i tunelit dukej i errët dhe i pafund", "Midis të metave kemi edhe dobësi" dhe pjesa e tretë, "Sistemi ndërroi si të ishte një fletë libri". Pjesa e dytë e "Secili çmendet simbas mënyrës së vet", si edhe e pjesa e parë, merret me komunizmin shqiptar, tashmë në momentet e grahmave të tij, me kohën kur ai dukej më i frikshëm dhe më i rrezikshëm se kurrë.

Veprat e Stefan Çapalikut në frëngjisht, serbisht e maqedonisht

"Secili çmendet simbas mënyrës së vet" II vjen dhe shuhet në misterin e rënies së sistemit politik në dhjetor të vitit 1990.

Ky cikël romanesk në pikëpamje teorike ka lidhje të drejtpërdrejtë me termin Bildungsroman, term që më së pari u krijua në 1819 nga filologu gjerman Karl Morgenstern në leksionet e tij universitare, dhe më pas u rimorr dhe u trajtua ndër stilema edhe më të kërkim të përgjigjeve për pyetjet themelore të jetës, me shpresën se këto përgjigje do i formulojë vetë rritja dhe zgjerimi i përvojës. Zhanri shpesh përbën një konflikt themelor ndërmjet karakterit kryesor dhe shoqërisë. Cikli romanesk "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" udhëhiqet prej dy predispozitash të forta emocionale. Ka vetëm dy emocione në botë, vetëm dy emocione që mund të shprehim, dhe këto dy emocione janë: frika dhe dashuria. Të gjitha emocionet e tjera me të cilat jemi aq familjarë, nuk janë asgjë më shumë se nënkategori të këtyre dyjave. Ku ka dashuri mund të ketë paqe, gëzim, qetësi, e në anën tjetër, aty ku sundon frika do kemi ankth, trishtim e lodhje. Kur personazhi kryesor ka frikë, ai i kthen shpinën jetës dhe, kur dashuron, ai ia hapë të gjithë dyert pasionit dhe ngazëllimit. Në faqet e romanit autori mëson ta dojë veten e vet me të gjithë lavdinë dhe papërsosmëritë e veta. Veçanërisht në këtë vëllim të dytë ai vë në ballë moton e John Lennon, që thotë se: "Nëse nuk mundemi ta duam veten, nuk mund të jemi plotësisht të hapur ndaj aftësisë sonë për të dashur të tjerët dhe gjithashtu ndaj potencialit tonë për të krijuar". Përkthyesit Ardian Marashi për versionin në frëngjisht, Danillo Brajoviç për versionin në serbisht dhe Jordana Shemko për versionin në maqedonisht, kanë përkthyer për siglat e botuesve Meet" në Francë, "Clio" në Serbi dhe "Ars lamina" në Maqedoni.

ÇFARË DO BËHET ME KIÇO LONDON? MINISTRIA HAP THIRRJE PËR DREJTOR

Ministria e Kulturës ka hapur dje një thirrje për drejtor të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", post të cilin e mban prej katër vitesh Kiço Londo. Në fund të mandatit të tij, ministria e linjës kërkon që secili kandidat të paraqesë një platformë për drejtimin e teatrit. Thirrja vjen në një kohë kur vetë e ardhmja e godinës së Eksperimentalit dhe teatrit si institucion është vënë në pikëpyetje pas projekteve qeveritare për shembjen e dy godinave të viteve 1930 e ndërtimit të një godine të re trekatëshe aty.

THIRRJA

Ministria e Kulturës shpall konkursin për pozicionin: Drejtor në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" - Kategoria e pagës II-b. Për arritjen e objektivave artistikë, pretendeti duhet të ndërtojë një platformë nxitëse për nxitjen e ideve të reja dhe eksperimentale në teatër, pjesë e së cilës të jenë një strategji sa më gjithëpërfshirëse në gjuhën dhe mjetet shprehëse teatrale të koncepteve bashkëkohore në stile, gjini artistike dhe aplikimin e një gjeografie sa më të gjerë të diversitetit kulturor. Kandidati duhet të zhvillojë marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet arsimore përmes projekteve që nxisin përfshirjen dhe krijimtarinë e të gjithë grupmoshave në përgjigje të politikës së Ministrisë "Edukim Përmes Kulturës"; të krijojë lidhje me strukturat ekonomike dhe ato të biznesit publik e privat për të ndërgjegjësuar dhe tërhequr një publik të ri; të dëshmojë kreativitet dhe të ndërmarrë nisma frymëdhënëse për të fituar audienca të reja; të sigurojë ligjshmëri dhe transparencë të kontratave individuale dhe procedurave të punësimit; të ndërtojë një plan buxhetor financiar të qartë vjetor, të bëjë të mundur rritjen e të ardhurave përmes burimeve të treta; të ngrejë një sistem treguesish vlerësimi të punës së institucionit për të lehtësuar dialogun me Ministrinë e Kulturës prej nga varet. Kërkohet që kandidati/ët të: kenë arsim universitar dhe kualifikime plotësuese në fushat e: artit, menaxhimit të artit kulturor dhe drejtimit të projekteve kulturore; përvojë të konsiderueshme në drejtim, menaxhim dhe krijimtari në fushën e artit skenik; përvoja ndërkombëtare në fushat e përmendura në pikën a dhe b; përvojë në drejtimin e institucioneve kulturore e artistike dhe ti dëshmojë ato; të njohë problemet aktuale dhe sfidat e teatrit shqiptar me qëllim reformimin e tij përkrah modeleve më të mira bashkëkohore; të ketë përvojë në konceptimin dhe ekzekutimin e projekteve afatgjata në fushat e artit dhe të kulturës; të ketë përvojë në ndërtimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve me donatorë dhe grupe të tjera interesi, si dhe në ngritjen e fondeve prej burimeve të ndryshme - si të sektorit publik ashtu dhe privat dhe t'i dëshmojë ato; të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit si dhe me partnerët vendorë e ndërkombëtarë; të ketë përvojë me teatrin e të rinjve dhe në programe të edukimit përmes kulturës; të ketë përvojë në artin multimedial, të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze, gjuhë të tjera të huaja përbëjnë avantazh.

Kiço Londo

Opinioni i Ditës

Ndahet qeveria në Amerikë, ja mësimet për politikën në Shqipëri

Nga Julian Zyla

(vijon nga faqja 1)

... amerikan, por korsitë e pushtetit tashmë do të jenë pjesërisht në duart e kundërshtarëve të tij. Dhoma e ulët e Kongresit amerikan u fitua nga demokratët, e majta.

Qeveritë në republikat presidenciale, si në Amerikë, apo semipresidenciale, si në Francë, quhen të ndara kur presidenti është i njërës parti dhe legjislativi ose një pjesë e tij është e partisë tjetër. Në Francë kjo mundëson dhe "bashkëjetesën" midis një presidenti dhe një kryeministri të dy partive të ndryshme. Është rast ndryshe nga republikat parlamentare, ku presidenti është jopolitik.

Por, humbja e Dhomës së Përfaqësuesve nga partia e Trump nuk sjell leksione mbi funksionimin e institucioneve, pasi ato janë të ndara në Kushtetutë, por mbi mënyrat e bërjes politikë. Kjo më sjell ndërmend njerëzit e bukur të Tiranës. Cilët janë?

Njerëzit e bukur të Tiranës i sheh nëse del nga shtëpia diku para orës tetë të mëngjesit. Janë në nxitim duke çuar fëmijët në kopsht apo shkolla me veshjet e tyre të rregullta. Ndonjëherë parkojnë në radhë të dytë, duke u kujdesur të mos pengojnë dhe të mos vonohen shumë. Fytyrat e tyre kanë shtyrë problemet për disa orë më vonë, kur të jenë në zyrë. Tashmë u thonë mirupafshim fëmijëve, të cilëve u kanë dëgjuar muhabetet e tyre prej fëmijësh që i kanë kënaqur. Njerëzit e bukur të Tiranës janë edhe shitësit apo pastruesit në rrugë, që bëhen pjesë e energjisë rigjeneruese të atyre orëve të mëngjesit. Të gjithë në zyra! Të gjithë duke u marrë me pjesën tjetër të ditës. Njerëzit e bukur të Tiranës i sheh sërish të nesërmen me punën e tyre, me fëmijët e tyre, me ditën e tyre studentore.

Shumica e këtyre njerëzve nuk e ndjekin politikën sa komentatorët, gazetarët apo politikanët. Nëse një lajm politik ka mbërritur tek ata, ose ka qenë shumë i rëndësishëm, ose shumë interesant. Çdo gjë tjetër në politikë, nuk përfshihet në interesin e njerëzve të bukur.

Në Amerikë, Hillary Clinton humbi prej një kohe të gjatë lajmesh politike kryesisht të zhvilluara pa jashtë interesit të njerëzve të bukur. Trump fitoi, por mendoi se tashmë njerëzit do të vazhdonin të mos shfaqnin interes. Kështu, gaboi. Lajmet e tij ishin dhe shumë të rëndësishme dhe, fatkeqësisht, shumë interesante. Njerëzit e painteresuar kthyen kokën. U menduan dhe votuan.

Në këto zgjedhje në Amerikë u votuan më shumë kandidate gra se ndonjëherë. U votua për herë të parë një guvernator homoseksual i hapur. Vota ishte krejtësisht në drejtim të asaj që perceptohej si realitet në SHBA: valë progresiste. Çfarë mund dhe duhet të mbajë shënim politika shqiptare?

Demokratët amerikanë arritën te votuesit e tyre duke kuptuar problemin real që kishin: daljen në votime. Demokratët korrën frytet e një kundërshtari, që fatmirësisht për ta kishte filluar të besonte se mund ta vendoste ai se çfarë ishte më e rëndësishme për publikun e gjerë, të njerëzve të bukur. Demokratët u përpoqën të frymëzonin më tepër: duke u përqendruar te vlerat e njerëzve të bukur dhe duke gjetur mënyrat për t'i përkthyer këto vlera në politikat e tyre.

Nuk është e thjeshtë të bësh fushatë mbi gjënë më të rëndësishme. Shpesh mund të tërhiqemi nga ajo që është më e rëndësishme për ne dhe të harrojmë që elementi përcaktues mund të mos jetë përbërje, por diçka teknike thellësisht e domosdoshme si pjesëmarrja në votime e mbështetësve tanë. Njerëzit e bukur dalin në mëngjes për të shoqëruar prindërit ose fëmijët, por jo gjithmonë ndihen të frymëzuar për të shoqëruar një politikan.

Sa i përket ndihmës që Donald Trump u dha demokratëve, ajo ishte rezultat edhe i mosdëgjimit ndaj disa këshilltarëve. Këtë gjë mund ta ketë bërë edhe Hillary Clinton dy vjet më parë. Trump besoi tepër në aftësitë e tij për të kanalizuar vëmendjen e njerëzve. Kishte harruar fuqinë e shumicës së heshtur. Kishte harruar fuqinë e njerëzve të bukur.

Së fundmi, demokratët këtë herë arritën të frymëzonin. Nuk e morën dot Senatin, ku matematika u dha republikanëve një shumicë edhe më të konsoliduar, por mësimi që mund të nxirret është që politika është emocion. Trump u kishte dhënë shumë material për emocion dhe ata nuk e shpërdoruan. Herë tjetër kanë qenë demokratët që kanë pasur tepër vetëbesim. Por këtë herë jo vetëm besuan, por edhe punuan. Dëgjuan elektoratin e tyre dhe u përgjigjën duke treguar se ishin pasqyra që kërkonin.

Tashmë, eskorta e Trump do të duhet të lëvizë ndoshta edhe më shumë në Uashington. Por, demokratët e Kongresit me shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve janë gati t'i vënë pengesa rrugës së tij politike. Trump do të mësojë edhe mësimet e veta. Do të mësojë durim. Do të mësojë mbi nevojat e njerëzve të bukur dhe fuqinë e tyre për të ndarë qeverinë.

Dje *në* "Deutsche Welle"

Tregtia korruptive me nënshtetësitë europiane

Ng Keno Verseck

(vijon nga faqja 1)

... njëkohësisht edhe shumë të dëshiruara. Kërkesat e larta kanë krijuar vitet e fundit një treg, nga i cili përfitojnë edhe zyrtarët e korruptuar në disa vende të BE-së, duke bërë falsifikime. Por kjo nuk mjafton. Edhe zyrtarisht, vendet e BE-së nuk e lenë t'u shpëtojë ky burim fitimprurës të ardhurash, prandaj ushtrojnë një regjim vizash të ashtuquajtur, "Viza të arta", një tregti me vlerë miliardash me nënshtetësitë dhe lejet e qëndrimit për vendet europiane.

Rasti i fundit i zbuluar në këtë tregti vjen nga Bullgaria. Në fillim të javës së kaluar u arrestuan dy duzina zyrtarësh, të cilët për vite me radhë kanë lëshuar ilegalisht certifikata prejardhjeje bullgare për qytetarë të Maqedonisë, Moldavisë dhe Ukrainës, duke marrë si shpërblim mijëra euro.

Ai që zotëron një certifikatë të tillë prejardhjeje sipas ligjit mund të marrë nënshtetësinë bullgare. Autoriteti përkatës në Bullgari është zyra për bullgarët që jetojnë jashtë vendit, SABA. Shefi i zyrës, i shkarkuar ditën e hënë, Petar Haralampiev, një politikan nacionalist, mendohet të jetë koka e rrjetit të korrupsionit.

Në fakt, kjo gjë është e ditur prej vitesh. Që më 2012, "Deutsche Welle" ka raportuar për shpërdorimet në dhënien e certifikatave nga SABA. Që në vitin 2013, juristja Katja Mateva, ish-drejtoreshë e sektorit të dhënies së nënshtetësisë në Ministrinë e Drejtësisë në Bullgari u ka dorëzuar informacionet përkatëse shefave të saj në qeveri. Në vitin 2014, ish-zëvendësministri Petko Petkov i dërgoi një memorandum për këtë çështje kryeministrit të përkohshëm, Georgi Blisnaschki, por asgjë nuk ndryshoi.

Mateva thotë në bisedë me "Deutsche Welle"-n se politikanët kanë bërë presion për vite me radhë, deri sa më në fund e shkarkuan në vitin 2017. Kurse Petkovit iu desh të dëgjonte nga politikanë të tjerë që i thonë se është tradhtar. Si Mateva, ashtu edhe Petkov thonë se deri tani ka munguar vullneti politik për t'i dhënë fund korrupsionit në dhënien e nënshtetësisë. Fakti që tani janë arrestuar njerëzit përgjegjës ka të bëjë me luftërat për pushtet brenda qeverisë, që luhen nga njëra anë nga partnerët në koalicion, partia GERB e kryeministrit Bojko Borissov dhe partia aleate nacionaliste e djathtë, Patriotët e Bashkuar dhe nga ana tjetër brenda Patriotëve të Bashkuar vetë. Disa thonë se me arrestimet e bëra tek SABA, Borissov kërkon të vendosë nën kontroll partinë Patriotët e Bashkuar, dhe t'u dërgojë një sinjal partnerëve të koalicionit.

PRAKTIKA TË TILLA NË DISA VENDE TË BE

Duke pasur parasysh këtë është e paqartë nëse biznesi korruptiv për dhënien e nënshtetësisë do të marrë fund apo jo dhe nëse njerëzit përgjegjës do të dënohen. Bullgaria nuk është i vetmi vend me praktika të tilla. Në Rumani dhe Hungari, një certifikatë prejardhjeje e tillë çon po ashtu në marrjen e nënshtetësisë. Në Rumani, nga ajo përfitojnë kryesisht qytetarët nga Moldavia, ku dy të tretat e popullsisë janë me prejardhje rumune. Po ashtu, në Ukrainë jetojnë pakica të mëdha rumune dhe hungareze. Po ashtu si në Bullgari, edhe në Rumani dhe Hungari jepen prej vitesh certifikata prejardhjeje, gjë që është keqpërdorur dhe mijëra rusë dhe ukrainas kanë marrë nënshtetësinë rumune dhe hungareze. Dimensione aspak më të vogla ka edhe dhënia zyrtare e nënshtetësisë dhe vendit të rezidencës në Bashkimin Europian, që praktikohet nën emrin "Viza e artë". Nëpërmjet kësaj, qytetarë jo të BE-së mund të marrin kundrejt pagesës ose investimit milionash, nënshtetësi ose leje të vazhdueshme qëndrimi. Gjysma e vendeve të BE-së, mes të cilave Bullgaria, Greqia, Britania e Madhe, Letonia, Lituania, Malta, Austria, Portugalia, Spanja, Hungaria dhe Qipro ofrojnë programe të tilla. Dhjetë vitet e fundit janë shitur me këto programe 6 mijë nënshtetësi dhe 100 mijë leje qëndrimi, bën të ditur "Transparency International dhe Global Witnes", në një raport të botuar në fillim të tetorit. Të ardhurat nga këto programe kanë qenë 25 miliardë euro. Programet e "Vizave të Arta", bëjnë larje parash dhe përdoren për biznese kriminale, prandaj BE duhet t'u japë fund praktikave të tilla, theksojnë OJQ-të. Një nga rastet më dyshuese ka të bëjë me programin hungarez për "Vizat e Arta", i cili ka funksionuar deri në vitin 2017 dhe për të cilin nuk ekzistojnë të dhëna. Megjithatë, gazetarë të qendrës investigative "Direkt36" kanë nxjerrë kush janë përfituesit kryesorë të saj. Sipas të dhënave të botuara tri javë më parë, politikanë rus, anëtarë të shërbimeve të larta sekrete ruse dhe njerëz besnikë të diktatorit sirian Assad, kanë marrë nënshtetësinë dhe leje qëndrimin hungarez. Edhe biznesmeni saudit, Ghaith Pharaon, që kërkohej në SHBA për mashtrime dhe larje parash ka marrë lejeqëndrimin hungarez dhe ka kërkuar të marrë nënshtetësinë. Ndërkohë, ai ka ndërruar jetë në vitin 2017.

"Këto praktika rrisin rreziqet në çështjet e sigurisë jo vetëm për Hungarinë, por për të gjithë Bashkimin Europian", thotë redaktori i "Direkt36", András Pethö. "Në të ekziston një kontradiktë e madhe. Nga njëra anë qeveria hungareze del kundër migracionit, por me programin e "Vizave të Arta" fut në BE shumë njerëz nga jashtë, të cilët nuk i kontrollon njeri".

> Rasti i fundit i zbuluar në këtë tregti vjen nga Bullgaria. Në fillim të javës së kaluar u arrestuan dy duzina zyrtarësh, të cilët për vite me radhë kanë lëshuar ilegalisht certifikata prejardhjeje bullgare për qytetarë të Maqedonisë, Moldavisë dhe Ukrainës, duke marrë si shpërblim mijëra euro.

HOROSKOPI

DASHI

Do të ishte mirë të kërkonit fonde për të punuar për disa projekte të reja. Ka gjasa të merrni një lajm të mirë, i cili do t'ju lumturojë pafund. Përkushtojuni më shumë marrëdhënies suaj romantike duke bërë të pamundurën për ta çuar këtë lidhje përpara.

DEMI

Mos i shpenzoni energjitë duke debatuar për gjëra të panevojshme. Disa kontrata të reja do t'ju duken fitimprurëse, por nuk do t'ju sjellin të ardhurat që ju dëshironi. Mos ndërmerrni vendim të nxituara, pasi mund t'ju shkaktohen probleme.

BINJAKET

Joga dhe meditimi do të ndikojnë shumë mirë në shëndetin tuaj. Ka gjasa t'ju përmirësohet gjendja financiare për shkak të të ardhurave të papritura. Vizita në një vend fetar apo tek i afërmi juaj mund të jetë në planet tuaja.

GAFORJA

Personat e kësaj shenje që vuajnë nga tensioni duhet të bëjnë kujdes dhe të mbajnë kolesterolin nën kontroll. Të afërmit do të tregohen të gatshëm sot t'ju ndihmojnë në çdo moment. Ka gjasa të debatoni me partneren/partnerin tuaj për shkak të mendimeve të ndryshme lidhur me disa çështje.

LUANI

Mos ndërmerrni vendime të nxituara, pasi mund të dëmtoni jo vetëm veten, por edhe familjen. Gjendja financiare do t'ju përmirësohet, teksa do t'ju shlyejnë disa pagesa të prapambetura. Ka gjasa që bashkëshorti/bashkëshortja juaj të mësojë një sekret nga e kaluara.

VIRGJERESHA

Do të bënit mirë të ushtroheshit më shumë fizikisht. Ka gjasa që disa probleme financiare t'ju shkatërrojnë mundësinë për të menduar në mënyrë konstruktive. Partneri/partnerja juaj mund të jetë në pritje të një dhurate nga ju. Sa i përket çifteve të martuar, gjithçka duket për mrekulli sot.

PESHORJA

Përpiquni të relaksoheni sa më shumë pas pune. Fëmijët mund t'ju zhgënjejnë, pasi nuk do të marrin rezultatet që ju prisnit. Ka gjasa që të takoheni me një person tepër interesant sot, çfarë do t'ju trazojë mendimet.

AKREPI

Duhet të kontrolloni ndjenjat. Sot duhet të përqendroheni në disa çështje, të cilat kanë lidhje me pasuritë e paluajtshme. Partneri/partnerja juaj do të kërkojë më shumë përkushtim ndaj lidhjes suaj. Mos bëni premtime, të cilat vështirë se mund t'i përmbushni.

SHIGJETARI

Për të pasur një jetë më të mirë, përpiquni të mendoni pozitivisht. Atmosfera festive në shtëpinë tuaj do t'ju lehtësojë tensionin. Mos iu nënshtroni kërkesave të panevojshme të partnerit/partneres suaj.

BRICJAPI

Xhelozia mund t'ju trishtojë dhe rëndojë psikologjikisht. Motivojeni veten që të dilni nga kjo gjendje dhe të ecni përpara. Përmirësimi i të ardhurave do t'ju çojë drejt disa blerjeve të rëndësishme. Mos u sillni me përulje në marrëdhënien tuaj romantike.

UJORI

Sigurohuni që të merrni aprovimin e të gjithëve në shtëpi përpara se të bëni disa ndryshime në arredimin e saj. Mund ta përmirësoni marrëdhënien tuaj romantike duke i kushtuar më shumë kohë njëri-tjetrit.

PESHQIT

Fëmijët do t'ju ndriçojnë ditën. Njerëzit rreth jush do t'ju japin shumë shpresë, por gjithçka do varet nga përpjekjet tuaja. Partneri/partnerja juaj do t'ju kënaqë pa masë me fjalët e tij/saj dhe do t'ju tregojë rëndësinë tuaj në jetën e tij/saj.

CHAMPIONS LEAGUE

Junajid befason Juven, Siti luan 'tenis' me Shakhtarin

Umbyllën edhe ndesh jet e xhiros së katërt në Ligën e Kampionëve. Mançester Junajtid fitoi me përmbysje brenda në Torino, me shifrat 1-2 ndaj Juves, përmbysje e cila erdhi në vetëm 6 minuta. Pjesa e parë pa Juven më agresive në kërkim të golit, por zhbllokimi erdhi vetëm në minutën e 65-të, me Ronaldon që shënoi një

gol mjaft të bukur. Por, në minutat 84-ët dhe 99-të ndodhi ajo që më pak pritej dhe ekipi i Murinjos përmbys falë perlës së Matës dhe një autogoli të Aleks Sandros. Në sfidat e tjera, Bajerni fitoi 2-0 ndaj AEK-ut, ndërsa fitoren më të thellë e shënoi Mançester Siti, që në fushën e tij mposhti me goleadë Shakhtrar Donjeckun, 6-0. Roma e kishte më të vështirë fitoren, pasi në tansfertën ruse u desh një karton i kuq i CSKA-së, që të merrnin tri pikët. Golat nga Manolas (4') dhe Pelegrini (59') zhbënë golin e Sigurdson (51'), duke iu dhënë fitoren kryeqytetasve italianë. Me këto tri pikë, Roma ruan hapin e Realit të Madridit, që nga ana e tij shkatërroi çekët e Viktoria Plzen me rezultatin 5-0. Ndërsa Valencia e kishte disi më të lehtë marrjen e tri pikëve, pasi nuk e vunë në diskutim asnjëherë takimin kundër Jang Bojs. Edhe pse miqtë zviceranë barazuan provizorisht, Valencia shënoi edhe dy herë të tjera, duke i mposhtur kampionët e Zvicrës me rezultatin 3-1.

LIGA E KAMPIONEVE

TË MËRKURËN

GRUPI E

Bajern Mynih - AEK Athinë	2-0
Benfika - Ajaks	1-1

GRUPI F

Lion - Hofenheim	2-2
Man.Siti - Shaktar Donjeck	6-0

GRUPI G

CSKA Moskë - Roma	1-2
Viktora Plzen - Real Madrid	0-5

GRUPI H

Valencia - Jang Bojz	3-1
Juventus - Man.Junajtid	1-2

Të kuqtë vuajnë me Kastriotin, por falë dygolëshit të Bardhit marrin tri pikë, që e ngjisin në krye

Partizani merr komandën, Laçi thyen Skënderbeun

Kurbinasit triumfojnë 2-0 me korçarët

Jeton Selimi

Partizani i falet Jur gen Bardhit, sul muesit fushë-krujas, që feston me një dygolësh ditëlindjen e tij të 21-të, çka u lejon kryeqytetasve të mposhtin Kastriotin me rezultatin 2-1 dhe të rimarrin vendin e parë në renditje pas dy javësh. Në stadiumin "Redi Maloku" të Fushë-Krujës, Bardhi shënon dy gola të shpejtë. Të parin në minutën e 20-të, pasi një mosmarrëveshjeje të portierit Kuka me mbrojtjen dhe golin e dytë në minutën e 35-të, kur shfrytëzon më së miri harkimin perfekt të Kotes, duke mposhtur Kukën me kokë. Por, Kastrioti rikthehet në lojë vetëm 60 sekonda më pas, kur Zhunior shfrytëzon ngathtësinë e Gojkoviç për të shkurtuar shifrat në 2-1. Më pas ndeshja bëhet agresive, me ndërhyrje të ashpra nga ana e Kastriotit, që gjithsesi i afrohet barazimit në pjesën e dytë, por pa arritur të shkëpusë një pikë nga ky takim. Partizani nga ana tjetër përfiton maksimalisht nga ndalesa e Skënderbeut, merr kreun dhe bëhet gati të presë Laçin në fundjavë.

LAÇI ËSHTË I TRETI

Dhe çfarë kapërcimi! Bardhezinjtë e drejtuar nga Migen Memelli kanë "çmontuar" Skënderbeun në kryeqytet, pasi ndeshja mes tyre u zhvillua në "Selman Stërmasi". Laçi ka shënuar nga një gol për çdo pjesë loje, duke nënshtruar kampionët 2-0 dhe duke marrë një fitore që e ngjit në vendin e tretë, katër pikë poshtë Skënderbeut të vendit të dytë, që ndaj kurbinasve shfaqi një lojë apatike dhe pa kreativitet, çka u kushtoi vendin e parë në renditje, që këtë javë bëri sërish rokadën me Partizanin. Golat nga Shtubina në minutën e shtatë dhe me Gjonin në minutën e 85-të, dy gola në ekstremet e ndeshjes, që karikojnë Laçin për sfidën e radhës të dielën ndaj Partizanit, një tjetër përballje me vendin e parë për të besuarit e Memellit.

SUPERLIGA

JAVA E 12-të

TË MARTEN

Tirana - Kukësi	0-0

TË MERKUREN

Kastrioti - Partizani	1-2
Kamza - Teuta	1-3
Laçi - Skënderbeu	2-0
Flamurtari - Luftëtari	0-0

RENDITJA

Skuadra	N	P
Partizani	12	28
Skënderbeu	12	26
Laçi	12	22
Kukësi	12	20
Teuta	12	21
Flamurtari	12	19
Tirana	12	10
Luftëtari	12	10
Kamza	12	8
Kastrioti	12	4

PAQE NË VLORË

Flamurtari-Luftëtari nuk ka dhuruar gola. Sfida e luajtur në Vlorë ka përfunduar me rrjeta të paprekura, ndërsa vlonjatët edhe njëherë drejtojë gishtin e akuzës nga gjyqtari i takimit, Olsid Ferhataj, që në minutën e 9-të nuk pa një prekje të topit me dorë në zonën gjirokastrite, ndërsa në minutën 33-të e konsideroi të rregullt ndërhyrjen në zonë Liçajt ndaj Mustës, ndonëse kuqezinjtë pretenduan një 11-metërsh. Vlonjatët humbasin një mundësi të mirë për të fituar pozicione në renditje, ndërsa gjirokastritët marrin një pikë me vlerë në luftën për mbijetesë.

Gjobë shoqërisë së sigurimit, procedim administrativ ndaj Tiranës

Policia shoqëron 12 tifozë në komisariat, merr pamjet filmike të ndeshjes

Policia e Shtetit ka bërë të ditur emrat e personave, të cilët janë arrestuar si përgjegjës për ngjarjet e turpshme që ndodhën në stadiumin "Selman Stërmasi" gjatë ditës së djeshme, në fund të ndeshjes Tirana-Kukësi. Policia ka bërë të ditur se të gjithë përballen me padi penale për prishje të rendit dhe sigurisë. Por ndërkohë, ka bërë të ditur se edhe kompania e sigurimit që ishte punësuar për këtë sfidë nga bardheblutë do të përballet me sanksione, pasi punonjësit e saj nuk kanë përmbushur detyrimet. Gjithashtu, një çështje penale është hapur edhe ndaj klubit Tirana që nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për marrjen e masave të sigurisë për ndeshjen në fjalë. Këto probleme ishin konstatuar që në derbi dhe Tirana nuk kishte bërë asgjë për t'i korrigjuar. "Lidhur me situatën e krijuar pas mbarimit të ndeshjes, policia menjëherë bëri kapjen dhe shoqërimin pranë Komisariatit të Policisë Nr.2 të 12 tifozëve prishës të rendit dhe të sigurisë, si më poshtë: Amarildo Gjoni, 18 vjeç, banues në Tiranë; Donald Bilushi, 37 vjeç, banues në Tiranë; Briken Karaj, 18 vjeç, banues në Tiranë; Iraldi Karaj 18 vjeç; Altin Vrapi, 31 vjeç; Ledio Pepa, 20 vjeç; Daniel Doce, 18 vjeç; Klevi Shaphasa, 18 vjeç; Hamit Hakrama, 21 vjeç; Oltion Halili, 18 vjeç; Kameliano Maliq, 18 vjeç; Luis Zhllima, 22 vjeç të gjithë banues në Tiranë", lexohet ndër të tjera në njoftimin e Policisë së Shtetit. Masa janë marrë edhe ndaj kompanisë së sigurimit "Octapus Security", e cila është gjobitur, ndërsa vazhdojnë procedurat për procedimin administrativ të Klubi Sportiv "Tirana" dhe drejtuesve të saj për mosbzatimin dhe marrjen e masave bazuar në ligjin Nr. 19/2016, datë 22.09.2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Humanisti i Rotterdamit
6. Mund të jenë cigaresh.
12. Capirossi i MotoGP.
13. Eshtë bixhoz
14. I vetmi në orar.
15. Para Diego në Kaliforni.
16. Fillojnë sefte.
17. Eshtë makina për guidë.
21. Inicialet e Benigni-t.
23. Janë riparime.
25. Janë të brishtë.
27. Fillojnë largimin.
28. Ishin kambistë të dikurshëm.
29. Një motoskaf gare.
31. Kështu thirrej Marco Pantani.
32. Janë penjtë për moline.
33. Emër vajze.
35. Janë edhe ato të cirkut.
36. Nuk ka tradhtari.
37. Janë baballarët.
38. Fillojnë titrat.
39. Ai dhe ajo.
40. Mbledh baskët separatistë.
41. Fillojnë saldimin.
42. Gjysma e krahut.
45. Në krye të armatës.
46. Gjysmë krisme.
47. Jepet për hartim.

VERTIKAL
1. Paul që qe poet i famshëm.
2. Dennis i Mclaren.
3. Këndohet në opera.
4. Gjysmë siklet.
5. Kufijtë e matjes.
6. I zhvillon kongresi.
7. Inicialet e Moravia-s
8. Janë krerë bandash.
9. Të fundit në tender.
10. Fund shkurti.
11. Mund të jenë grosistë
13. Ka shirit magnetik një e tillë.
15. Ishin engjej të korit të lartë
17. Janë gjynahet
18. Bega komik.
19. Janë shemra.
20. Inicialet e Morricone-s.
22. Janë edhe ato fetare.
23. Një gjuajtës francez.
24. Gjika e Dora D'Istria-s.
26. Qytet grek.
29. Bëjnë katrorë me një kat.
30. Ishin ndjekësit e Antistenit.
32. Shkruhet i treti.
34. Një sulm... kardiak.
36. Ki Moon i OKB
40. Inicialet e Rohmer.
43. Robert Mitchum.
44. Dy asa.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Bëhet një me psonisje.
5. Një mund të jetë qeveritar
11. Maiden që këndojnë.
13. Një ushtarak është solemn.
15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
16. Teket pa kufij.
18. Mbetet në fund.
19. Një treshe në skenë.
21. Një mongol i Timurlengut
23. Një peshk i rëndë.
25. Tiriac ish-tenist
26. Kufizojnë një takim.
27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
30. Fillojnë nazet
31. Kalimi në krye.
32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
34. Janë portet.
35. Dashi kur mungon ai
37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.
40. Një birrë.
41. Mbetur në fund.
42. Ramazzotti këngëtar
43. Janë në modë.
44. Janë tek në shaka.
45. Eshtë dite në mbledhje.
47. Një pjesë e kandidaturave.
49. Jessica Parker aktore.
50. Inicialet e Presley.
51. Akoma është ndryshe.
52. Janë brinjët në skuadër.
53. Qendër fitimi

VERTIKAL
1. Brad aktor.
2. Komandohet nga gjenerali.
3. Në hyrje të zonës
4. Janë në skaje
6. Janë librat e parë
7. Mund të jetë arme.
8. Incialet e Turgeniev.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Mund të lakohet.
12. Janë araknidet si vejshua e zezë.
14. Mund të jetë e lirë në port.
17. Një mjet lundimi.
20. Shkroi Rinoceronti.
22. Ekstreme në ritëm.
24. Kalohen në gjumë.
28. Filmi i parë shqiptar.
29. Fillojnë takimet
31. Kufizojnë kënde.
32. Një depozitë drithi.
33. Janë vendet e para.
34. Një parabolë e tenistit.
36. Eshtë llogari që qërohet.
37. Shteti me Khartum.
38. Janë kapot e bandave.
40. Një thirrje e dëshpëruar nga direku.
41. Lidhin brigje.
42. Një lidhëz
46. King Cole i muzikës.
48. Fillojnë ndeshjen.
49. Sapo fillojnë.
50. Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

6		5			2			
		3		9			2	1
8							9	6
				5		2		7
	4							
1	2	6		7	8	3		
	8			3	9		7	
3	6	1	7	2			8	
7			4			6	3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	1	2	9	7	3	6	8	4
7	8	3	6	2	4	1	9	5
4	6	9	1	5	8	2	3	7
9	7	4	2	8	5	3	1	6
8	2	6	3	1	7	4	5	9
1	3	5	4	6	9	8	7	2
6	9	1	7	3	2	5	4	8
3	4	8	5	9	6	7	2	1
2	5	7	8	4	1	9	6	3

Argëtim filozofik

-Mënyra më e mirë për të korruptuar një të ri është ta udhëzosh të ketë mendim më të lartë për ata që mendojë si ai se sa ata që mendojnë ndryshe.
-Çfarë është djallëzi. Çfarëdo që del nga dobësia.
-Shumë janë kokëfortë në kërkim të rrugës që kanë zgjedhur, pak në kërkim të qëllimit.
-Arma më e mirë kundër një armiku është një tjetër armik.
-Avantazhi i një kujtese të keqe është se mund të shijosh disa herë të njëjtën të mirë si për herën e parë.

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

T	E	K		B	O	M		B	R	E	D	H		
O	R	A	T	O	R	E	T		E	S	E			
G		N	O	T	A	R	E	T		T	M	T		
E		A	M	E	R	I	K	A	N	E	T			
R	S	L		R	E	T	E		E	R	I	K		
	P	E	L	O	T	A		D	V		M	A		
S	O	T		R		T	A	R	E		E	T		
T	R				G		P	A	R	E	T	E		
E	T	L		A	R	I	T	M	I	A				
F	I	L	I	Z	A	T		E	A		G	A		
A			D	I	T	E	T			T	O	M		
N	O	B	I	L	E		B	A	N	A	L	E		

Thënie të mençura

-Nuk vritet me zemëratë, por me qeshje.
-Kujdes kur të lexoni libra shëndeti. Mund të vdisni për një gabim shtypi.
-Unë nuk mora pjesë në funeral, por dërgova një letër të këndshme kur thuhej se e miratova.
-Nuk e kam lejuar asnjëherë shkollimin të ndërhyjë me arsimimin.
-Njeriu që nuk lexon libra të mirë nuk ka asnjë avantazh ndaj atij që s'mund t'i lexojë.
-"Përse rrini heshtur me pamjen e një zarfi pa adresë sipër?"

FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Gazeta e gjithë shqiptarëve!

Kontakt: +355 68 40 63 842

Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube Youtube: Gazeta Shqiptare

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al